



USHTRIA



Viti i 75-të i botimit Nr. 38 (827790)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 23 Shtator 2022

Gjeneral brigade Arben Kingji merr pjesë në takimin e Komitetit Ushtarak të NATO-s

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Arben Kingji mori pjesë në takimin e Komitetit Ushtarak të NATO-s, që u zhvillua në Tallin, Estoni. Konferenca u drejtua nga kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, Admirali Rob Bauer. Në këtë takim, krahas shefave të Mbrojtjes të vendeve anëtare të NATO-s, merrnin pjesë edhe Komandanti i Komandës Supreme Aleate për Europën

(SACEUR), gjeneral Christopher G. Cavoli dhe Komandanti i Komandës Supreme Aleate për Transformim (SACT), gjeneral Philippe Lavigne. Gjatë Konferencës së Komitetit Ushtarak të NATO-s, shefat e Mbrojtjes diskutuan gjerësisht zhvillimet më të fundit të situatës gjeopolitike me rëndësi strategjike, jo vetëm për Aleancën por edhe më gjerë, si dhe zbatimin e vendimeve të marra gjatë Samitit të NATO-s që

u zhvillua në Madrid në qershor të këtij viti. Gjatë sesioneve të Konferencës dyditore, shefat e Mbrojtjes theksuan nevojën e ndërmarrjes së veprimeve dhe planeve konkrete në përballjen e kërcënimeve rajonale, duke synuar rritjen e efektivitetit dhe të shpejtësisë së dislokimit të forcave sa herë që do të jetë e nevojshme. Me vëmendje të veçantë nga drejtuesit e lartë ushtarakë... >> faqe 5



Ekipi i NATO-s në Shqipëri, asistencë mbi sulmet kibernetike Ministri Peleshi: Duke qenë një prej aleatëve të NATO-s na bën të jemi të sigurt, por njëkohësisht duhet vigjilencë nga të gjitha institucionet



Certifkohet Grup - Batalioni i Këmbëtorisë së Lehtë nga NATO

Në përfundim të stërvitjes certifikuese të Grup - Batalionit të Këmbëtorisë së Lehtë (GBKL), "Biza - 22", u organizua në Poligonin Kombëtar të Bizës, Dita e Vizitorëve të Shquar. Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, i shoqëruar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneral brigade Arben Kingji, gjatë fjalës së tij, shprehu vlerësimet dhe mirënjohjen për të gjithë ata që kontribuan në realizimin me sukses të kësaj stërvitjeje, që siç tha ai, konsiderohet si një prej arritjeve më domethënëse të Forcave të...



Faqe 2

"Një veprimtari përkujtimore domethënëse"


Në qytetin e Fierit, përkujtohet 79-vjetori i daljes partizane, në radhët e Ushtrisë Nacional Çlirimtare, në një ditë, i 68 vajzave fierake. Përkujtimi u zhvillua në qendër të Fierit, tek monumenti i Heroinës të Popullit Liri Gega dhe tek memoriali përballë saj, kushtuar veprës unike të 68 vajzave të Fierit, më 14 Shtator 1943. Organizata e Veteranëve dhe Pasardhësve të LANÇ-it, Dega Fier, në bashkëpunim edhe me Bordin Drejtues të Shoqatës Kombëtare të Ushtarakëve në Rezervë të Shqipërisë...



Faqe 6

Dimri, Donacionet dhe "Dritharmët" - 3D në "Operacionin special"

"Operacioni special" nuk është aspak i kufizuar, ai është drejtuar jo vetëm në një rajon të Ukrainës, jo vetëm në Ukrainë, madje jo vetëm në Europë. Rreziku i përdorimit të armëve bërthamore është akoma opsion, për faktin se rusët e kanë të vështirë të pranojnë humbjen dhe të tërhiqen nga operacioni i tyre "special". Egoja dhe "lëndimi" i sedrës së fituesit të përgjithshëm u shfaq edhe në fjalën e tij, më 20 shtator, e cila nuk i lejon liderët autoritarë të pranojnë se po humbasin. Për të përmbysur rezultatin, diktatorët...



Faqe 10



Certifikohet Grup - Batalioni i Këmbërorisë së Lehtë nga NATO

Ministri Peleshi: Mbrojtja e territoreve të Aleancës është detyra parësore e jona dhe aleatëve tanë. Sfidat të reja na presin

Në përfundim të stërvitjes certifikuese të Grup - Batalionit të Këmbërorisë së Lehtë (GBKL), "Biza - 22", u organizua në Poligonin Kombëtar të Bizës, Dita e Vizitorëve të Shquar.

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, i shoqëruar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneral brigade Arben Kingji, gjatë fjalës së tij, shprehu vlerësimet dhe mirënjohjen për të gjithë ata që kontribuan në realizimin me sukses të kësaj stërvitjeje, që siç tha ai, konsiderohet si një prej arritjeve më domethënëse të Forcave të Armatosura, certifikimit të Grup - Batalionit të Këmbërorisë së Lehtë sipas standardeve të NATO-s.

"Kërkesa e Aleancës për certifikimin dhe rritjen e nivelit të gatishmërisë të forcave të saj, bëhet edhe më 'immediate' sot në realitetin e ri të sigurisë, të cenuar rëndë pas agresionit ushtarak të Rusisë ndaj Ukrainës. Mbrojtja e territoreve të Aleancës është detyra parësore e jona dhe aleatëve tanë, një detyrë të cilën, nuk na lejohet të mos e përmbushim", - u shpreh ministri Peleshi, ndërsa falënderoi aleatin strategjik, Shtetet e Bashkuara të Amerikës për mbështetjen.

Ministri i Mbrojtjes tha se: "puna e palodhur e disa ekipeve të Gardës së New Jersey-it, por edhe atashimi pranë GBKL të një strukture speciale amerikane, Special Force Assistance Brigade (SFAB), bën të mundur realizimin e objektivit tonë në një kohë pothuaj rekord".

Gjatë fjalës së tij, ministri Peleshi foli edhe për sfidat që i presin Forcat e Armatosura në të ardhmen e afërt: "Dua të inkurajoj Forcat tona të Armatosura, që me përgjegjësi dhe profesionalizëm, të angazhohen në realizimin e stërvitjeve kombëtare dhe atyre të përbashkëta të planëzuara me NATO-n dhe me Komandën Amerikane në Europë (USAREUR). Sfidat e radhës është padyshim stërvitja "Defender Europe 2023". Në vijim të suksesit të "Defender Europe 21", në këtë stërvitje, në vendin tonë do ngrihet Brigada Ndërkombëtare, pjesë e "Task Force South", me kontribute nga vendet e Iniciativës "SHBA - Karta e Adriatikut". Më lejoni të rikonfirmoj angazhimin tonë në misionet e NATO-s në Kosovë (KFOR), Letoni (eFP), Irak, si edhe në misione të drejtuara nga OKB (Sudani i Jugut) dhe Bashkimi Europian (EUFOR, BiH). Viti 2023 do të jetë një vit sfidues për Forcat tona të Armatosura, të cilat do të duhet, që krahas rritjes së prezencës në misionet aktuale, të marrin pjesë edhe në operacionet detare "FOCOPS" dhe "Agean Sea" me një anije të klasit "Iliria", - u shpreh Ministri i Mbrojtjes.



Grup - Batalioni i Këmbërorisë së Lehtë iu nënshtrua vlerësimit operacional, sipas sistemit "Combat Readiness Evaluation" (CREVAL) të NATO-s, në stërvitjen certifikuese "Biza - 22", duke marrë kështu certifikimin si "Combat Ready".

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Arben Kingji, në përshëndetjen e tij me rastin e përmbylljes me sukses të Stërvitjes "Biza - 2022" dhe certifikimit të GBKL-së, adresoi një mirënjohje të veçantë për të gjithë aleatët dhe partnerët, në veçanti SHBA-të, për asistencën e tyre në rritjen e nivelit operacional dhe profesional të Grup - Batalionit të Këmbërorisë së Lehtë.

Më tej, gjeneral brigade Arben

Kingji theksoi se Grup - Batalioni i Këmbërorisë së Lehtë pas këtij certifikimi do të hyjë në një fazë



tjetër të rëndësishme të modernizimit dhe angazhimit operacional, që nga kompletimi me armatim



të ri dhe të unifikuar ashtu edhe rritjes së fuqisë së zjarrit, si pjesë e elementeve të mbështetjes me luftim, pajisje zbulimi dhe përmirësimi i infrastrukturës.

"Falë mbështetjes në trajnim, stërvitje dhe modernizim, shtabi dhe personeli i Grup - Batalionit kanë rritur aftësitë dhe kapacitetet profesionale të tyre, duke qenë të aftë të operojnë me trupat e vendeve Aleate dhe ato partnere...", - u shpreh ndër të tjera në përshëndetjen e tij gjeneral brigade Kingji.

Në Ditën e Vizitorëve të Shquar, me rastin edhe të kësaj arritjeje morën pjesë edhe ambasadorë të huaj të akredituar në Shqipëri, deputetë të Komisionit parlamentar të Sigurisë, si dhe atashe të vendeve aleate.

Ekipi i NATO-s në Shqipëri, asistencë mbi sulmet kibernetike

Ministri Peleshi: Duke qenë një prej aleatëve të NATO-s na bën të jemi të sigurt, por njëkohësisht duhet vigjilencë nga të gjitha institucionet

Një ekip i NATO-s ka mbërritur në Shqipëri, për të asistuar qeverinë në nivel politik dhe teknik pas sulmeve kibernetike. Vizita vjen pas komunikimit të kryeministrit Edi Rama me Sekretarin e Përgjithshëm të Aleancës, z. Jens Stoltenberg.

Delegacioni i kryesuar nga Zëvendës Ndhmës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, për Sfidat e Reja të Sigurisë, z. James Appathurai, u takua fillimisht me ministrin e Mbrojtjes Niko Peleshi.

Gjatë konferencës së përbashkët, ministri Niko Peleshi sqaroi qëllimin e vizitës së ekipit të Aleancës në vendin tonë: “Ky ekip vjen në vendin tonë për të dhënë asistencë në lidhje me çështjet kibernetike, njohje me situatën aktuale si dhe nevojat dhe mundësitë për adresimin e këtyre çështjeve në vazhdim. Pas sulmeve kibernetike ndaj sistemeve dhe infrastrukturës së teknologjive të informacionit të shtetit shqiptar, tashmë të identifikuar për nga origjina, i menjëhershëm ka qenë reagimi dhe përgjigja e strukturave të specializuara të vendit në bashkëpunim të ngushtë me vendet aleate. Këto sulme kishin për qëllim shkatërrimin e plotë të sistemeve dhe platformave të shërbimeve shtetërore, por nuk arritën qëllimin e fshirjes dhe shkatërrimit të të gjithë sistemeve tona të teknologjive të informacionit. Qeveria shqiptare reagoi menjëherë, pasi siguroi prova të pakundërshtueshme për origjinën e sulmit, duke ndërprerë menjëherë marrëdhëniet me Iranin. Aleatët tanë dënuan ashpër sulmet dhe dolën krah Shqipërisë nëpërmjet deklaratave të ndryshme, apo dhe me afrimin e asistencës së specializuar në fushën kibernetike”.

“Aktualisht, pas afro 5 javësh punë intensive, është bërë i mundur rikthimi i sistemeve dhe platformave të ndryshme në shërbim të qytetarëve të vendit tonë”, - sqaroi ministri i Mbrojtjes.

Sipas ministrit Peleshi: “këto sulme kanë treguar se nuk mund të jemi të mbrojtur në mënyrë permanente, por duhet të jemi vigjilentë dhe të aftë të mbrojmë infrastrukturën dhe teknologjitë e informacionit të vendit tonë, duke investuar më shumë në drejtim të luftës kibernetike. Investime të shumta janë bërë këto vite, por kjo është një luftë e re që ka marrë tjetër intensitet edhe pas agresionit rus në Ukrainë, që ka prishur ekuilibrat gjeopolitikë dhe ka ndryshuar skemën e sigurisë”.

Ministri garanoi se sistemet e sigurisë dhe mbrojtjes në Ministrinë e Mbrojtjes kanë qenë të paprekura nga sulmi, sepse janë të shkëputura nga rrjeti i përgjithshëm i komunikimit, por pavarësisht kësaj është rritur gatishmëria dhe niveli i vëmendjes dhe sigurisë për të gjitha këto sisteme.

Ministri Peleshi falënderoi edhe aleatët për qëndrimin e mbajtur menjëherë pas sulmeve, duke ofruar



asistencën e tyre për të penguar sulmet kibernetike në të ardhmen: “Vizita e ekipit të sotëm është një dëshmi solidariteti e mbështetjes, e

reagimit të menjëhershëm të Aleancës ku ne bëjmë pjesë, NATO-s. Duke qenë një prej aleatëve të NATO-s na bën të jemi të sigurt,

por natyrisht duhet më shumë vigjilencë nga të gjitha institucionet”, - u shpreh ministri Peleshi.

Ndërsa Zëvendës Ndhmës Sek-

retari i Përgjithshëm i NATO-s, për Sfidat e Reja të Sigurisë, z. James Appathurai, u shpreh se në këtë rrugëtim Shqipëria nuk është e vetme, sepse NATO e mbështet: “Të gjitha vendet e NATO-s e njohin sulmin që i është bërë Shqipërisë dhe sigurisht e mbështesin atë në këtë drejtim. Ky është dhe mesazhi që sekretari i Përgjithshëm i dha kryeministrit Rama në takim in e kaluar. Sigurisht doja të theksoja dhe përpjekjet e shumta që ka bërë shteti shqiptar duke nisur nga qeveria deri poshtë te niveli i ulët për të përballuar këto sulme që janë bërë. Sigurisht ndihma ka ardhur nga NATO, ka ardhur në nivel teknik nga vende të ndryshme të NATO-s, por edhe në nivelin individual nga struktura të ndryshme. Unë dhe ekipi im kemi ardhur këtu për disa arsye të ndryshme, por fillimisht arsyeja kryesore është për të parë situatën dhe për të bërë një koordinim të aleatëve dhe zyrave qendrore të NATO-s në lidhje me sulmin kibernetik që ka ndodhur, për të parë nevojat afatgjata që i nevojiten Shqipërisë, për të ndër-tuar një rrjet mbrojtjeje ndaj këtyre sulmeve kibernetike dhe Shqipëria po bën hapa përpara në këtë fushë”, - u shpreh z. Appathurai, duke theksuar edhe një herë për mbrojtjen e Aleancës në këtë betejë.

Ekipi i NATO-s do të takohet edhe me përfaqësues të Ministrisë së Jashtme, Ministrisë së Brendshme, si dhe me përfaqësues të AKSHI-t.

Mbyllet në Gjermani stërvitja “Saber Junction 22”



Stërvitja e koduar “Saber Junction 22”, u zhvillua në bazën “Albertshof” në Hohenfels, Gjermani. Në këtë stërvitje morën pjesë rreth 4 500 trupa nga 8 shtete të ndryshme. Shqipëria u përfaqësua në këtë eveniment me një skuadër EOD prej 6 vetash me komandant toger Klejdis Plaku. Skuadra EOD ishte e atashuar pranë Batalionit Parashutist Xhenier të Brigadës 173 amerikane të stacionuar në Vicenza, Itali.

Gjatë stërvitjes dhe sidomos gjatë fazës së ekze-

kutimit, skuadrës EOD iu dhanë në total 6 detyra për identifikimin dhe çaktivizimin e pajisjeve eksplozive të improvizuara (IED) dhe asgjësimin e municioneve konvencionale (UXO) të paplasura. Falë përgatitjes, trajnimeve, pajisjeve dhe eksperiencës, skuadra EOD tregoi nivelin e lartë profesional.

Në përfundim të stërvitjes toger plaku dhe skuadra EOD morën përgëzime dhe inkurajime nga drejtuesit më të lartë të kësaj stërvitje.





Kujtohet 80 - vjetori i Konferencës së Pezës

Ministri Peleshi: Shqiptarët e kanë treguar se kur rreziku i tejkalon problemet e brendshme, ne bëhemi bashkë, ngrihemi mbi dallimet, nuk na ndan as feja, as krahina, as ideja

Në aktivitetin që u zhvillua në nder të kësaj dite, aty ku u mbajt Konferenca e Pezës, morën pjesë edhe ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi si dhe zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Manushaqe Shehu.

Në fjalën e tij, ministri i Mbrojtjes vlerësoi rolin e veteranëve dhe pasardhësve të tyre, në mbajtjen gjallë të kësaj dite dhe mesazheve që Konferenca e Pezës ka përcjellë ndër vite edhe tek brezi i ri:

“Ashtu si në Besëlidhjen e Lezhës, apo në Lidhjen shqiptare të Prizrenit edhe këtu në Pezë, më 16 Shtator 1942, instinkti kombëtar i mbledhi bashkë të gjithë shqiptarët, pa dallime, përballë një rreziku, një kërcënimi të madh, pushtuesit fashist, në atë kohë, italian. Shqiptarët e kanë treguar se sa herë rreziku i tejkalon problemet e brendshme, ne bëhemi bashkë, ngrihemi mbi dallimet, nuk na ndan asgjë, as feja, as krahina, as ideja”, - u shpreh ministri Peleshi.

“Shqipëria, - tha më tej ministri i Mbrojtjes gjatë fjalës së tij, - u rreshtua në anën e duhur të historisë, gjë që sot i jep vendit një pasaportë dhe të drejtë morale për të trokitur me dinjitet dhe me ballin lart në Bashkimin Europian, përkrah forcave përparimtare”. “Por, - shtoi më tej ministri Peleshi, - sot, jemi përballë disa rreziqeve që nuk janë vetëm rreziqe potenciale, por janë sulme të ndodhura kibernetike.”

“Kjo në fakt është një luftë e sotme dhe e së ardhmes. Është edhe më e fortë edhe më e rrezikshme se lufta fizike. Shqipëria sot është anëtare dinjitoze në Aleancën më të fuqishme politike dhe ushtarake që është NATO. Kjo na bën të jemi të sigurt, të mbrojtur, por padyshim nuk i bën zero rreziqet dhe kërcënimet, siç ishte ky i fundit. E dini që bota ka ndryshuar, skena e sigurisë në botë ka ndryshuar, pas sulmit rus të pushtimit të pajustificuar në Ukrainë. Gjeopolitika ka ndryshuar dhe ne jemi në mes të një rajoni shumë të brishtë, siç është Ballkani Perëndimor, por Shqipëria në Ballkanin Perëndimor është vendi i vetëm pa probleme të brendshme politike dhe pa dilema politike dhe gjeopolitike. Ne jemi të orientuar nga perëndimi dhe kemi një mision për të luajtur në të gjithë trevat shqiptare edhe jashtë



trupit të Shqipërisë për ta mbajtur Ballkanin nga perëndimi. Natyrisht që kjo përballje me forcat e tjera të errëta na jep dhe kosto, na ekspozon dhe na bën të jemi vigjilentë, por duhet të jemi dhe të mobilizuar me njëri-tjetrin, të ngrihemi mbi ato që na ndajnë e të bashkohemi në pakte kombëtare. Sot është mëkat të spekulosh me sulmin kibernetik ndaj Shqipërisë, sepse ajo nuk është një luftë kundër PS apo kundër qeverisë së PS, është një luftë kundër Shqipërisë për shkak

se Shqipëria ashtu si në Luftën II Botërore, edhe tani ka vendosur të rreshtohet përkrah NATO-s, përkrah SHBA-së, përkrah botës së lirë”, - u shpreh ministri i Mbrojtjes. Në aktivitetin e organizuar merrnin pjesë edhe drejtues të pushtetit vendor, anëtarë të Komitetit të Veteranëve si dhe banorë të zonës së Pezës. Më 16 Shtator 1942, në Konferencën e Pezës u mbledhën përfaqësuesit e të gjitha forcave politike të vendit dhe përpunuan platformën e përbashkët të Luftës Antifashiste Nacional - Çlirimtare.

Historia 64 - vjeçare e nëndetëseve shqiptare

Më 21 shtator 1958, u krijua Brigada e Nëndetëseve, (BrND). ND I (Whiski 613 C, Stuhia), ND II (Rrufeja), ND III (Vetëtim), ND IV (Tufani). Çlirimi i vendit nga pushtimi nazi-fashist e gjeti Shqipërinë pa flotë detare luftarake. Edhe ato pak mjete të thjeshta e primitive, që kryenin detyra mbrojtjeje e patrullimi në vijën bregdetare, u shkatërruan nga lufta.

Në dhjetëvjeçarin e parë të pasluftës, me ndihmën e BS, aleati kryesor i Shqipërisë ato kohë, u hodhën bazat e para për krijimin e një flote luftarake me motoskafë me armatim të lehtë dhe më pas me disa mjete të vogla e të shpejta luftarake, që quheshin “Katër Silurues”, pas tyre dhe disa “Dragamina”, me të cilat Shqipëria në ato kohë siguronte ruajtjen e kufijve detar të saj.

Shqipëria e vogël në hapësirën bregdetare kishte vende shumë strategjike për të zotëruar jo vetëm kufijtë detar të saj, por për gjithë hapësirën që përfshin edhe detin Jon e më tej në Mesdhe. Dhe një nga këto pika strategjike ishte Gjiri i Pashalimanit, një vend ideal strehimi, jo vetëm për ato pak anije luftarake që kishte Shqipëria ato kohë, por dhe për një flotë më të madhe e më moderne.

Kjo i tërhoqi vëmendjen aleatit të ngushtë që kishte Shqipëria në atë periudhë, Bashkimin Sovjetik. Në tetor të vitit 1957 erdhi për vizitë në Shqipëri, ish-ministri i Mbrojtjes i BS, Mareshtali i shquar i Luftës së Dytë Botërore, G. K. Zhukov, ku midis të tjerave, u vendos që gjiri strategjik i Pashalimanit të kthehej në një bazë të fuqishme luftarake detare jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për aleatët e saj në vitet '50 e '60-të të shekullit që shkoi, siç ishte “Traktati i Varshavës”, Aleanca Ushtarake e vendeve të lindjes komuniste.

Ishte një ëndërr për ushtrinë shqiptare, e veçanërisht për armën e marinës luftarake, ngritja e një flote të madhe e moderne, që nga fundi i viteve '50-të u bë realitet me ardhjen e mjeteve detare luftarake me përmasa të mëdha dhe së fundi grupi i nëndetëseve me bazën përkatëse, që i dhanë emrin “Flota Luftarake Detare (FLD) e Shqipërisë”, me atë uniformën e bukur të marinarëve, me pelerinën ngjyrë deti mbi supet dhe shiritat e zinj në kapelat shkruar me germa të mëdha: “Gjiri i Pashalimanit”, nga një strehë e thjeshtë e mbrojtjes së anijeve peshkarexhë nga erërat e stuhishme detare, në vitet 1957-'58, u kthye shpejtë në një port modern luftarak për ankorimin e mjeteve mbi dhe nën ujore të Flotës së Re Detare Shqiptare të porsa ngritur.

Madhëshinë e kësaj flote e plotësoi dhe ardhja e nëndetëseve në gushtin e vitit 1958, me lundrimin e tyre të gjatë nga baza e Kaliningradit në brigjet e Baltikut verior të BS, të udhëhequra nga baza e tyre lundruese, “Njemçinova”, që në Shqipëri mori emrin “Tomori”, e drejtuar nga Admirali rus Jorgorov, i cili vite më vonë në betejat politike ruse-shqiptare, u personifikua me personazhin e “Zheliznovit” në filmin shqiptar të viteve '60-të, “Ballë për Ballë”, të shkrimtarit Ismail Kadare. Emra të argjenditë, “Flota Luftarake Detare”. Kapitëni i Rangut të Parë, Xhemal Shani, që u bë komandant i Brigadës së Nëndetëseve, si dhe komandantët Dashamir Ohri, Spiro Kote, Shyqyri Çukaj dhe Beqir Gërbi. Teknika e re dhe e vështirë për efektivat shqiptarë, u përvetësua në një kohë rekord, në sajë të vendosmërisë e përkushtimit, duke marrë në dorëzim postet dhe mjetet luftarake, që kohë pas kohe realizuan stërvitje me nivel të lartë luftarak. Një shembull të tillë tregoi ekipazhi i nëndetësës së dytë të Brigadës së Nëndetëseve, me lundrimin e parë të saj të gjatë e të vështirë prej 21 ditësh, në thellësi të ujërave të Adriatikut, Jonit dhe deri në Mesdhe. Ishte një stërvitje



Forca **DETARE**



e vështirë, për faktin se i gjithë lundrimi dhe fazat e stërvitjes prej 21 ditësh u zhvilluan nën ujë me nivele të ndryshme thellësie, pa dalë në

sipërfaqen e ujit. Nëndetësja drejtohej nga komandanti, toger Shezai Kasa, zëvendëskomandanti, toger Skënder Doçi, inxhinieri mekanik, toger Korab Mejvani e detarë të tjerë.

Ky lundrim u realizua në korrik të vitit 1959, pothuaj një vit pas ardhjes së kësaj teknike të re për flotën tonë luftarake. Lundrimi ishte i detyrueshëm për t'u realizuar në thellësi të ujërave detare, për shkak jo vetëm të kërkesave të stërvitjes në kushte lufte të vështirësive maksimale, por dhe të situatës që përjetonte vendi ynë në atmosferën e “Luftës së Ftohtë”, që zhvillohej midis dy kampeve kundërshtarë dhe kur Flota e 6-të Amerikane ishte e pranishme në ujërat e Detit Mesdhe. Brigada e Nëndetëseve përbënte atë kohë armën dhe teknikën më moderne të Flotës sonë Luftarake Detare dhe kjo detyrë, sa e rëndë dhe e vështirë, kërkonte angazhim e sakrificë maksimale, për të cilat ekipazhet përkatëse me komandantët e tyre në krye, i realizuan me sukses. U shquan mjaft nga këta kuadro drejtues të arsimuar në shkollat ushtarake detare në Baku, Sevastopol dhe Shën Petërsburg të BS. Të tillë ishin: Xhemal Shani, Stavri Çika, Dashamir Ohri, Muharrem Lulollu, Shezai Kasa, Spiro Kote, Shyqyri Çuko, Beqir Gërbi, Skënder Doçi, Aleko Pojani, Petrit Myftiu e shumë të tjerë. Flota Luftarake Detare, përvëç Brigadës së Nëndetëseve në Portin e Pashalimanit, me bazën lundruese të përmasave të mëdha, “Tomori”, me komandant Stavri Çika, kishte dhe brigadën e anijeve luftarake mbijëse të ishullit të Sazanit, me “Gjuajtësit luftarak”, “Dragaminat” dhe “Katër-Siluruesit” e shpejtësisë së lartë, po ashtu dhe detashmenti i anijeve ndihmëse mbijëse siç ishin: anija e “Dragës”, që thelloi portin e Pashalimanit me komandant Izet Velçanin, anija e “Çmagnetizueses”, që shkarkonte nëndetëset dhe anijet e tjera luftarake nga ngarkesat elektromagnetike kundër fushave të minave detare, me komandant Xhevit Selimullari, anija cisternë, që furnizonte anijet luftarake me ujë e karburant me emrin, “Linda”, “Rimorkjatori” me fuqi të madhe tërheqëse, me komandant detarin e vjetër, Dulla, anijet e vogla “Hidrografike”, “Polumbarja” me grupin e palombarëve, e shumë e shumë anije të tjera ndihmëse. E gjithë ajo flotë luftarake, ishte një garanci për ruajtjen e kufijve detar të Shqipërisë, sigurisht e mbështetur dhe nga një artilleri e fuqishme bregdetare e instaluar në pikat më dominante të bregdetit, në ato kushte izolimi e rrethimi që përjetonte Shqipëria komuniste, shtu këtu dhe klimën e nderë të presionit që krijonte “Lufta e Ftohtë” midis dy kampeve rivale botërore.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Arben Kingji mori pjesë në takimin e Komitetit Ushtarak të NATO-s, që u zhvillua në Talin, Estoni.

Konferenca u drejtua nga kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, Admirali Rob Bauer.

Në këtë takim, krahas shefave të Mbrojtjes të vendeve anëtare të NATO-s, merrnin pjesë edhe Komandanti i Komandës Supreme Aleate për Europën (SACEUR), gjeneral Christopher G. Cavoli dhe Komandanti i Komandës Supreme Aleate për Transformim (SACT), gjeneral Philippe Lavigne.

Gjatë Konferencës së Komitetit Ushtarak të NATO-s, shefat e Mbrojtjes diskutuan gjerësisht zhvillimet më të fundit të situatës gjeopolitike me rëndësi strategjike, jo vetëm për Aleancën por edhe më gjerë, si dhe zbatimin e vendimeve të marra gjatë Samitit të NATO-s që u zhvillua në Madrid në qershor të këtij viti.

Gjatë sesioneve të Konferencës dyditore, shefat e Mbrojtjes theksuan nevojën e ndërmarrjes së veprimeve dhe planeve konkrete në përballjen e kërcënimeve rajonale, duke synuar rritjen e efektivitetit dhe të shpejtësisë së dislokimit të forcave sa herë që do të jetë e nevojshme. Me vëmendje të veçantë nga drejtuesit e lartë ushtarakë u diskutua edhe për operacionet dhe misionet aktuale të NATO-s NMI, në Irak, KFOR, dhe Kosovë.

Shefat e Mbrojtjes së Aleancës diskutuan gjithashtu edhe për të ardhmen e modelit të forcës, duke synuar promovimin e inovacionit, si dhe për të mbështetur operacionet në sa më shumë fusha dhe "domene", nëpërmjet transformimit dixhital.

Gjeneral brigade Kingji, gjatë takimit rikonfirmoi vijimin e kontributeve të Shqipërisë në misionet, operacionet dhe aktivitetet e Aleancës si dhe vlerësoi në veçanti misionin KFOR të NATO-s në Kosovë si kontribuues i drejtpërdrejtë për sigurinë dhe paqen. Gjithashtu, gjeneral brigade Kingji adresoi një falënderim të veçantë për të gjithë aleatët dhe partnerët, sidomos SHBA-të, për përgjigjen në kohë dhe ndihmën që i dhanë vendit tonë pas sulmit kibernetik iranian.

Gjeneral brigade Kingji zhvilloi një takim pune me Kryetarin e Komitetit Ushtarak të NATO-s,



Gjeneral brigade Arben Kingji merr pjesë në takimin e Komitetit Ushtarak të NATO-s



Admiral Bauer, ku u diskutua mbi situatën e sigurisë në Ballkanin Perëndimor, roli i KFOR-it, si dhe kontributi i FARSH në mbështetje të sigurisë dhe paqes rajonale.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Arben Kingji, mori pjesë gjithashtu edhe në takimin e organizuar nga shefi i Shtabit kanadez, gjeneral W.D Eyre, me vendet kontribuuese në grupbatalionin kanadez të Prezencës së Përparuar (eFP), në Letoni.

Komiteti Ushtarak përbëhet nga shefat e shtabeve të vendeve anëtare të Aleancës dhe është përgjegjës për këshillimin e autoriteteve politike të NATO-s mbi masat që konsiderohen të nevojshme për parandalimin dhe mbrojtjen e përbashkët të territorit të NATO-s, si dhe për zbatimin e vendimeve në lidhje me operacionet dhe misionet e NATO-s. Me statusin e të ftuarit, në këtë takim morën pjesë edhe shefat e mbrojtjes së Finlandës dhe Suedisë, vende që janë në rrugën e anëtarësimit në familjen e madhe Euroatlantike.

Gjeneral brigade Arben Kingji priti në takim ambasadorën e Kanadasë, znj. Elissa Goldberg

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Arben Kingji, priti në një takim kortezie ambasadorën e Kanadasë, znj. Elissa Goldberg, e cila shoqërohej nga atashu ushtarak kanadez, kapiten i rangut të parë Andre Boisjoli.

Në takim u vlerësua bashkëpunimi dypalësh në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë në kuadër të misioneve të NATO-s.

Gjeneral brigade Arben Kingji shprehu falënderimet ndaj Forcave të Armatosura kanadeze për

mbështetjen e dhënë në misionin e NATO-s në Letoni, ku FARSH kontribuon me kontingjentin nga kompania EOD në misionin për asgjësimin e municioneve të rrezikshme.

Në përfundim, të dy bashkëbiseduesit ndanë të njëjtin qëndrim për thellimin e bashkëpunimit në fushën e trajnimit dhe arsimimit ushtarak, kryesisht në fushën e Emergjencave Civile, CIMIC dhe Barazisë Gjinore, si dhe angazhimeve të përbashkëta në operacionet dhe stërvitjet në kuadër të Aleancës.





Në qytetin e Fierit, përkujtohet 79-vjetori i daljes partizane, në radhët e Ushtrisë Nacional Çlirimtare, në një ditë, i 68 vajzave fierake.

Përkujtimi u zhvillua në qendër të Fierit, tek monumenti i Heroinës të Popullit Liri Gega dhe tek memoriali përballë saj, kushtuar veprës unike të 68 vajzave të Fierit, më 14 Shtator 1943.

Organizata e Veteranëve dhe Pasardhësve të LANÇ-it, Dega Fier, në bashkëpunim edhe me Bordin Drejtues të Shoqatës Kombëtare të Ushtarakëve në Rezervë të Shqipërisë, e pasuruan këtë përkujtimore me pjesëmarrjen aktive të një përfaqësie prej 25 grave



“Një veprimtari përkujtimore domethënëse”

oficere, që 55 vjet më parë, në 1967, 70 vajza, ndër të cilat 60 për qind e tyre ishin bija të partizanëve, të cilat studiuuan në shkollën e Bashkuar të Oficerëve.

Simbolika e kësaj pjesëmarrjeje ishte evidentimi dhe vazhdimësia e rolit të vajzave dhe grave shqiptare në luftën për liri dhe mbrojtjen e saj. Në këtë përkujtimore, përveç deputetëve të Fierit dhe drejtuesve të pushtetit vendor, morën pjesë edhe anëtarë të SHKURSH, gra e burra, përveç Tiranës edhe nga degët e Vlorës, Lushnjës dhe Durrësit.

Kol (R) Thoma Konduri



NGA KOLANA E LIBRIT “OFICERET SHQIPTARE NË RRJEDHËN E HISTORISË”

Liri Gega, oficerja partizane, anëtare e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare

Liri Gega ka lindur në Gjirokastrë në vitin 1917 dhe ndërroi jetë në Tiranë, në vitin 1956.

Ajo ka qenë anëtare e Grupit Komunist të Shkodrës, vepërimitare e Partisë Komuniste të Shqipërisë, partizane dhe drejtuese formacionesh luftarake në luftë, si dhe anëtare e Byrosë Politike të Partisë së Punës të Shqipërisë. Liri Gega, gjatë Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare, ka pasur funksionin më të lartë ushtarak për kohën, ajo ka qenë anëtare e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare të Shqipërisë, oficer madhore që synonte që në atë periudhë, të merrte gradën e “Gjeneralit”, duke qenë kështu femra e parë ushtarakë e

Shqipërisë që do të kishte gradën më të lartë. Ndërsa martesat pak më vonë me Dali Ndreun, do të niste një kalvar të stërmundimshëm për këtë çift, deri në dënimin dhe pushkatimin e tyre. Liri Gega ishte vajza e vetme mes katër djemve të Besimit dhe Asijes. I ati Beso Gega, ishte farmacist i shkolluar jashtë vendit, ishte zgjedhur dhe kishte shërbyer si kryetar i Bashkisë Gjirokastrë. Liri Gega studioi në Tiranë në Institutin “Nana Mbretreshë”, ku mbaroi studimet në vitin 1935. Pasi mbaroi me rezultate shumë të mira këtë shkollë, shkoi për t’u shkolluar në Itali me bursë shtetërore dhe u regjistrua në Fakultetin e His-

torisë në Universitetin e Romës.

Pas kthimit në Shqipëri nisi punë në Tiranë, në Institutin ku kishte studiuar më parë, tashmë të riemërtuar “Donika Kastrioti”.

Në vitin 1941, Liri Gega ishte anëtare e Grupit Komunist të Shkodrës, ku bënin pjesë dhe Fiqret Shehu dhe Nexhmije Xhuglini. Nga viti 1941 ishte anëtare e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste.

Pasi doli në mal, u bë anëtare e Shtabit të LANÇ-it, Luftoi me Brigadën e Parë Sulmuese, në Maqellarë, komanduar nga Dali Ndreu. Pas luftës, në vitin 1946, u martua me Dali Ndreun, një prej ushtarakëve më të lartë të asaj kohe. Në vitet 1945-1948 ka qenë deputete e Kuvendit dhe një nga drejtueset kryesore të Organizatës së Gruas Shqiptare. Gega u dëbua nga Politbyroja dhe partia në vitin 1944 në një luftë fraksionale me Koçi Xoxen dhe punonte si mësuese e thjeshtë në shkollën pedagogjike “17 Nëntori”. Në vitin 1956 nisi punën si mësuese në Fier. Në vitin 1956 arrestohet si agjente e jugosllavëve. Në dhjetor të vitit 1956, Liri Gega së bashku me bashkëshortin e saj, Dali Ndreu, pushkatohe në një vend që nuk u mësua dhe sot...



INTERVISTË ME ZNJ. LILIANA KONOMI MERO, ISH-USHTARAKE E FA-SË, ANËTARE NË BORDIN E SHKURSH

Të ecësh me dinjitet në përballje me detyrat

Intervistoi: MIMOZA GOLIKJA

Znj. Liliana është njëra nga ish-ushtaraket e para të FA-ve, e titulluar oficere këmbësorie në korrik të vitit 1969, në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve në Tiranë. Ajo ka shërbyer si pedagoge e Taktikës për një vit dhe për shumë vite të tjerë në lëndën e Filozofisë Dialektike e Materialiste, po në këtë shkollë. Ka studiuar në Universitetin e Tiranës, dega Gjuhë shqipe - Letërsi dhe në fakultetin e Shkencave Politike Juridike, dega Juridik. Aktualisht ajo është anëtare në bordin e SHKURSH, ku ka qenë anëtare që nga fillimi i shoqatës. Ajo mban kontaktet me kolegë ish-ushtarakë, oficerë në rezervë dhe në lirim, në funksion të shoqatës dhe jo vetëm.

E intervistuar znj. Liliana Konomi Mero, në kuadër të 55-vjetorit të ish-kursit të parë të vajzave ushtarake të FA-së, intervistë të cilën po e sjellim më poshtë.

Znj. Liliana, do ta nisim intervistën me ju, në këtë 55-vjetor të ish-kursit të parë të vajzave ushtarake të FA-së, me një pyetje lidhur me pjesëmarrjen tuaj në një aktivitet, si simbol i një grupi oficeresh në rezervë. Pse shkuat në Fier?

Vajzja jonë në Fier ishte pjesë e kalendarit të aktiviteteve tona, por edhe të ftesës së bërë. Shkuam për të marrë pjesë në ceremoninë e organizuar nga Bashkia Fier në përkujtim të 14 shtatorin të vitit 1943, ditën e daljes së 68 vajzave fierake partizane.

Dalja e 68 vajzave fierake partizane, në mënyrë të organizuar, në një ditë, është një ngjarje e pa shembull dhe unike, jo vetëm në historinë e LANÇ, por edhe në historinë e Luftës së Dytë Botërore. Ne ishim një grup oficeresh në rezervë që shkuam për homazh në kujtim të tyre, por edhe në përfaqësimin e 70 vajzave të para, që po më 9 shtator 2022, kujtuam, se si 55 vjet më parë, nisën Shkollën e Bashkuar Ushtarake “Enver Hoxha” në Tiranë. Ato zgjedhën karrierën e oficeresh së Ushtrisë Popullore. Mund të themi me krenari dhe të renditim këtu edhe me dhjetëra e qindra shembuj të tjerë se vajzat e gratë shqiptare të pas Luftës iu janë, jo vetëm mirënjohëse partizaneve, por ndoqën me po aq guxim rrugën e çelur prej tyre për emancipim qytetar, duke kontribuar në rindërtimin e Shqipërisë të shkatërruar nga Lufta dhe, më pas për ndërtimin e Shqipërisë së re. Po jap vetëm një prej këtyre shembujve, vetëm një çerek shekulli më vonë nga Lufta II. Botërore dhe shtatori i vitit 1967 do të shënonte një gjurmë tjetër në histori që do përkujtohet, sepse për herë të parë në historinë e Shqipërisë, por edhe të Forcave të Armatosura të saj, do të nisnin arsimimin dhe përgatitjen luftarake dyvjeçare, shtatëdhjetë vajza nga e gjithë Shqipëria, nga jugu në veri, nga qytetet, por edhe fshatrat.

Është vërtet frymëzuese kur mendon sot, se si ju, 70 vajza, shënuat historinë, duke u bërë pjesë e një shkollimi sa të vështirë por dhe të paragjykuar, dhe kjo, jo vetëm për një vend si Shqipëria e atyre viteve. Çfarë ju shtyu?

Po, e vërtetë, sidomos për mentalitetin e kohës dhe shoqërisë.



Disave, madje u ishte miratuar e drejta e studimeve të larta universitare, por ishin vetë ato që do të zgjidhnin një tjetër shkollim, atë ushtarak. Do të krijohet e para kompani vajzash në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve, për oficerë, deri atëherë vetëm për djem. Ishte një kompani ajo e jona, si ajo çeta me vajza fierake e kohës së Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. 70 vajzat ishin nga e gjithë Shqipëria. Vinin nga qytete dhe fshatra, nga Malësia e madhe, Shkodra, Lezha, Mirdita, Tropoja, Peshkopia, Mati, Fushë Kruja, Durrësi, Tirana, Elbasani, Gramshi, Pogradeci, Korça, Kolonja, Përmeti, Vlora, Gjirokastra, Berati, Përmeti, Lushnja edhe nga Fieri. Studiuam në 3 specialitete. Pas titullimit oficerë, u shpërndanë nëpër Shqipëri. Iu besuan detyra nëpër reparte ushtarake, por edhe në shkollë, ku disa prej tyre do të mbaheshin për pedagoge. Ishin 5 oficerë dhe e gjashta komandante. Në Ministrinë e Mbrojtjes por edhe në Shtab shërbyen gjithashtu shoqet tona. Krahas punës ndoqën edhe degë të ndryshme në Universitet dhe pas vendosjes së gradave, morën gradën “nënkolonel” 6 vajza, “major” 13 vajza dhe “kapiten” të para 51 vajza.



Ishte vërtet krenari! E kush do ta mendonte atëherë, kur ne çelëm shtegun dhe hodhëm hapat në rrugën e bukur të uniformave të blerta. Por jemi krenare gjithashtu që aktualisht kemi oficerë karriere me detyra nga më të lartat, siç është gjeneralmajor Manushaqe Shehu, zëvendëseshë i SHPPFA. Por gjithashtu Fieri ka të drejtë të krenohet me një nga deputetet e tij oficerë karriere, Andoneta Dhima, apo me ish-kolonelën dhe ish-Prefektin e Tiranës Suzana Jahollari.

Ju e përmendët 14 shtatorin 1943, pse kaq e rëndësishme kjo datë për ju?

14 shtatori 1943, është një datë e rëndësishme për historinë, por sidomos për historinë e femrës shqiptare. Është dita e daljes partizane të 68 vajzave fierake. 79 vite më parë “... një çetë luftëtaresh të reja dilte nga një qytet i vogël, që atëherë nuk i kalonte 5-6 mijë banorë. Një rast ky unik në Shqipëri dhe, pse jo, edhe përtej saj në Europën e pushtuar nga nazifashistët. S’ kish kushtrim më të fuqishëm për luftë se sa ky fakt madhështor i këtyre vajzave të reja”. Kështu shkruan për to profesor Nasho Jorgaqi. Por edhe të shtatëdhjetë vajzat ishin përfaqësuese të një brezi tjetër të pas luftës, që ndoqën gjurmët e 6000 vajzave trimëresha partizane.

70 vajza vendosën t’i hynin një rruge të pashkelur, të përballonin gjithçka, mentalitetin mashkullor të shoqërisë, paragjykimet, të panjohurat e mëdha të kësaj jete të re, stërmundimet fizike dhe gjithë sakrificat e tjera që do të pasonin. Dhe është shumë domethënës fakti që nga 70 vajzat për oficerë 43 prej tyre (61.5%) ishin bija me njërin, por edhe me të dy prindërit partizanë. E pra, këto vajza ishin rritur dhe edukuar edhe me shembullin konkret të familjes me anëtarë partizanë. Në dy vitet e shkollës ato do të kryenin me sukses përgatitjen e tyre ushtarake. Më pas, do të shërbenin në të gjitha strukturat, në repartet e njësitë e Ushtrisë deri në Ministrinë e Mbrojtjes.

Si ju duken vajzat e tjera që zgjedhin të ndjekin rrugën që çelët ju si pjesë e Forcave të Armatosura?

Pas brezit të parë do të vazhdonin dhe shumë e shumë të tjera deri në ditët tona, nga viti në vit, nga dekadat në dekada të tjera, gjysmë shekulli më pas. Ne i ndjekim me interes dhe me gëzim gjeneratat e reja të vajzave që ecin krah djemve me uniformë, që kanë krijuar profilin e tyre dhe që janë po aq të denja për yjet që mbajnë mbi supet dhe që përfaqësojnë FA dhe Shqipërinë në misionet e detyra të rëndësishme jashtë vendit sa dhe burrat. Këto gra e vajza që kanë ecur me dinjitet në karrierën e tyre, çdo herë do të merrnin vlerësimet dhe mbështetjen e kolegëve, eprorëve dhe mbarë shoqërisë, për aftësitë e tyre të spikatura për të përballuar detyrat e vështira në fushën e përgatitjes politiko-luftarake të popullit.

Përveç të qenit bashkëshorte të mira, nëna të përkushtuara, gjyshe të ëmbla, cilat janë disa nga veprimtaritë tuaja shoqërore sot?

Pjesëmarrja në takimet me shoqatat homologe të vendeve të Rajonit të Ballkanit, aktivitetet me rastin e Vitit të Ri me nipër e mbesa të anëtarëve të Shoqatës. Ditëlindje shoqesh, pjesëmarrje aktive në të gjitha aktivitetet e rëndësishme gjatë një çerek-shekulli. Kontribut në themelimin e Shoqatës nga viti 1996 dhe mbarëvajtjen e saj deri në 25-vjetorin e saj. Pjesëmarrje në demonstratat dhe marshimet e protestave ndaj mohimit të drejtave ekonomiko-sociale të ushtarakëve të liruar, me famëkeqin nenin 24/1. Pjesëmarrje me mbështetjen e MM në aktivitetet kombëtare për ngjarje madhore të periudhës së Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, si në 75-vjetorin e formimit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, në Labinot. Në 75-vjetorët e çlirimit të Tiranës, Gjirokastrës dhe Korçës. Në Berat një nga 2 jubiletet për Kongresin e Gruas Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe në shumicën e aktiviteteve të zhvilluara në Tiranë.

Seksioni i grave ka zhvilluar aktivitete si vizitë në Vlorë për 100-vjetorin e Pavarësisë 2012, vizitë në Prizren, më 10 qershor, për përvjetorin e Lidhjes së Prizrenit. Shëtitje në Shkodër, në Apoloni, në Divjakë, në Belsh & Divjakë, përreth Liqenit të Ohrit, në Karpen të Kavajës, në ish-fushimin e Shkollës së Bashkuar të Oficerëve “Enver Hoxha”, përkujtimi i datave të shënuara si dhe 7-8 marsin etj. Gjithçka e bëjmë për të qenë aktive në jetën shoqërore e sociale të vendit dhe për të qenë në krah të brezave të rinj me sa të mundemi.



Përshtati: MIMOZA GOLIKJA

Epokë e re për sigurinë globale

Shefat e Mbrojtjes të NATO-s diskutuan operacionalizimin e strategjisë së NATO-s për të parandaluar dhe mbrojtur

Vetëm pak ditë më parë shefat e Mbrojtjes aleate u mbledhën për konferencën e tyre vjetore, në Tallin, Estoni, Konferencën e Komitetit Ushtarak të NATO-s, me pjesëmarrjen për herë të parë edhe të Finlandës dhe Suedisë si të ftuar. Agjenda pasqyroi mjedisin e ndryshuar të sigurisë si dhe zbatimin e vendimeve të marra në Samitin e NATO-s në Madrid, qershorin e kaluar.

Komiteti Ushtarak i NATO-s u prit në Tallin me një ceremoni zyrtare hapjeje nga Presidenti i Republikës së Estonisë, Alar Karis. Në fjalimin e tij të mirëseardhjes, Presidenti theksoi ndryshimin drastik në mjedisin e sigurisë që nga pushtimi i Ukrainës nga Rusia dhe përforcimi i paçmuar që aleatët i kanë dhënë krahut lindor të NATO-s. Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s nënvizoi rolin thelbësor që luan Estonia, veçanërisht në fushën dixhitale, kur bëhet fjalë për mbështetjen e transformimit dixhital të NATO-s. Kurse kryeministria e Republikës së Estonisë, Kaja Kallas, theksoi rëndësinë e mbështetjes së gjerë ndërkombëtare për Ukrainën. Në fjalën e tij të hapjes, admiral Bauer tha se tashmë s'ka më asnjë dyshim se ka filluar një epokë e re për sigurinë globale. "I gjithë rendi ndërkombëtar i bazuar në rregulla është nën sulm. Dhe u takon kombeve të lira, demokratike të botës ta mbrojnë atë. Dimri po vjen, por mbështetja jonë për Ukrainën do të mbetet e palëkundur".

Në sesionin e parë të takimit shefat e Mbrojtjes së NATO-s diskutuan zbatimin e vendimeve të gjerë për parandalimin dhe qëndrimin e mbrojtjes të NATO-s, të marra nga lideri politik në Samitin e NATO-s në Madrid, si dhe operacionalizimin e strategjisë së parandalimit dhe mbrojtjes së NATO-s. "Kjo strategji siguron që planet kombëtare të ndërlihen më ngushtë me planet e Aleancës; Udhëheqësit ushtarakë kanë një kornizë të përbashkët referimi si për kërcënimet e gjera të Aleancës ashtu edhe për kërcënimet rajonale; dhe se ne rrisim shpejtësinë dhe efektivitetin e shpejtë të forcave tona të dislokueshme", - nënvizoi admiral Bauer.

Nga ana tjetër Komandanti Suprem i Aleatëve për Europën, gjeneral Christopher Cavoli, dha konsideratat e tij strategjike mbi qëndrimin aktual dhe të ardhshëm të NATO-s në krahun lindor dhe në të gjithë spektrin e qasjes 360 gradë të Aleancës ndaj sigurisë. Në një sesion kushtuar të ardhmes së Forcave të Armatosura, Komandanti Suprem i Aleatëve për Transformimin, gjenerali Philippe Lavigne u dha shefave të Mbrojtjes njohuritë e tij për promovimin e bashkëpunimit në fusha dhe degë shërbimi për të mundësuar transformimin dixhital.

Në një sesion kushtuar promovimit të diversitetit në Forcat e Armatosura, Shefat e Mbrojtjes shkëmbyen ide se si të krijojnë një grup më të larmishëm talentesh në fuqinë e tyre punëtore. Admirali Bauer tha se kjo është e rëndësishme për të rritur efektivitetin në fushën e betejës dhe për shkak se "krijimi i një kulture të përfshirjes është thelbësore për besimin mes burrave dhe grave me uniformë. Pa besim nuk mund të funksionojmë", - nënvizoi ai. Admirali Bauer, Kryetar i Komitetit Ushtarak të NATO-s dhe gjeneraljtënant Martin Herem, shefi i Forcave të Mbrojtjes të Estonisë, në fund të konferencës informuan mediat mbi rezultatet e takimeve.

Siguria globale nën presion

Si një "republikë dixhitale", Estonia që udhëheq rrugën në elasticitetin kibernetik dhe shërbimet gjithëpërfshirëse qeveritare në internet, u zgjodh si vend pritës i Konferencës vjetore të Komitetit Ushtarak të NATO-s. "Aleanca përfiton shumë nga ekspertiza e Estonisë në shkëmbimin e informacionit, shfrytëzimin e lirisë së lundrimit në fushën e informacionit, sistemet lidhëse, përshtatja, për të mundësuar elasticitet në internet dhe jashtë linje", - tha admiral Rob Bauer. "Është e mrekullueshme të shohësh, ndjesh dhe përjetosh, shpirtin e qëndrueshëm të popullit estonez. Nderimi për historinë tuaj dhe kujtimin e të gjithë atyre që kanë luftuar dhe kanë vdekur në emër të paqes, lirisë dhe demokracisë është i kudondodhur. Estonia është një vend që ka qëndrueshmëri në ADN-në e saj", - tha Admirali. Në kushtetutën estoneze është parashikuar që çdo qytetar ka të drejtë dhe detyrë të mbrojtjes pavarësisht e kombit të tij. "Estonia nuk e ka haruar të kaluarën e saj, por gjithashtu po përqafton plotësisht të ardhmen", - tha ai. Kjo konferencë erdhi në një kohë kur siguria globale është nën presion të jashtëzakonshëm. Lufta e paprovokuar e Rusisë kundër Ukrainës na ka futur në një epokë të re për sigurinë globale.

"Të gjithë jemi të mahnitur nga guximi i pamashë të Forcave të Armatosura të Ukrainës dhe popullit ukrainas, të cilët sprapsin kundërshtarin e tyre herë pas here. Aleatët e NATO-s do t'i mbështesin ata për aq kohë sa duhet. Dimri po vjen. Por mbështetja jonë do të mbetet e palëkundur. Është shumë e qartë se ky konflikt është më i madh se Ukraina dhe i gjithë rendi ndërkombëtar i bazuar në rregulla është nën sulm, por dhe nga ana tjetër janë edhe grupet terroriste që përdorin luftën asimetrike dhe krijojnë përçarje lokale dhe globale, si dhe ngritja e pamashë ushtarake e Kinës dhe retorika e rrezikshme. E gjithë kjo solli në vëmendje se NATO ka një detyrë të shenjtë për të mbrojtur 1 miliard qytetarë që jetojnë në tokën aleate, për të planifikuar dhe menduar gjithmonë faktin që të jetë gati për të pritur të papriturën".

Autoriteti më i lartë ushtarak i NATO-s gjatë gjithë sesioneve të tij të Konferencës, diskutoi mbi zbatimin e vendimeve të marra për parandalimin dhe qëndrimin mbrojtës të NATO-s, nga udhëheqja politike në Samitin e NATO-s në Madrid, si dhe "si të operacionalizohet strategjia e NATO-s" për të parandaluar dhe mbrojtur.

Strategjia e pengimit dhe mbrojtjes dhe mbështetja për Ukrainën

Komiteti Ushtarak mbylli takimin e tij me diskutimet që mbuluan gjerësinë e sfidave të sigurisë me të cilat përballet Aleanca, me "epokën e re për sigurinë globale", me konflikt "më të madh se vetë Ukraina", me sulmin mbi "rendin ndërkombëtar të bazuar në rregulla". Kryetari i Komitetit Ushtarak, admiral Rob Bauer tha se u takon kombeve të lira, demokratike të botës ta mbrojnë Ukrainën sot. "Sot, për herë të parë ndonjëherë, shefat e mbrojtjes aleate priten homologët e tyre finlandezë dhe suedezë rreth tryezës si të ftuar. Pranimi i Finlandës dhe Suedisë, me aftësitë e tyre mbrojtëse mbresëlënëse, do të rrisë sigurinë e rajonit të Detit Baltik dhe do



të forcojë Aleancën në tërësi", - tha ai. "Së bashku, ne diskutuam se si mund të forcojmë sigurinë tonë kolektive dhe si do të zbatojmë vendimet e gjera për parandalimin dhe qëndrimin mbrojtës të NATO-s, që u morën nga lideri politik në Samitin e NATO-s në Madrid. Komandanti Suprem i Aleatëve në Europë, gjenerali Cavoli, na dha konsideratat e tij strategjike në krahun lindor dhe në të gjithë spektrin e qasjes sonë 360 gradë ndaj sigurisë". Shefat e Mbrojtjes diskutuan për operacionalizimin e "strategjisë së pengimit dhe mbrojtjes" që miratuar në vitin 2020. Kjo strategji siguron që planet kombëtare janë më të ndërlidhura me planet e Aleancës. Udhëheqësit ushtarakë kanë një kornizë të përbashkët referimi si për kërcënimet e gjera të Aleancës ashtu edhe për kërcënimet rajonale dhe se ne rrisim shpejtësinë dhe efektivitetin e forcave tona të shpejta të dislokueshme", - theksoi admiral Bauer. "Po flasim për riparimin më të madh të strukturave tona ushtarake që nga viti 1949. Planifikimi për këtë ka filluar disa vite më parë, por tani po e zbatojmë".

Shefat e Mbrojtjes diskutuan gjithashtu se si do të mbështesin, por dhe si do të rrisin mbështetjen aleate për Ukrainën. "Municionet, pajisjet dhe trajnimet që Aleatët po ofrojnë po bëjnë një ndryshim të vërtetë në fushën e betejës. Me sukseset e saj në terren dhe në internet, Ukraina ka ndryshuar rrënjësisht luftën moderne. NATO do të mbështesë Ukrainën për aq kohë sa duhet. Dimri po vjen, por mbështetja jonë do të mbetet e palëkundur", - theksoi Kryetari i Komitetit Ushtarak, Bauer. Tema të tjera të agjendës ishin operacionet, misionet dhe aktivitetet e vazhdueshme të NATO-s, përfshirë misionin e NATO-s në Irak (NMI) dhe Forcën e Kosovës (KFOR). Shefat e Mbrojtjes i kushtuan një secancë të veçantë diversitetit në Forcat tona të Armatosura. "Jo vetëm sepse duam të praktikojmë vlerat që predikojmë, por edhe sepse të kesh një grup më të larmishëm talentesh në fuqinë tonë punëtore rrit efektivitetin tonë në fushën e betejës. Dhe më e rëndësishmja, krijimi i një kulture të përfshirjes është thelbësor për besimin mes burrave dhe grave me uniformë. Pa besim, ne nuk mund të funksionojmë. Ne duhet të vazhdojmë të zhvillohemi dhe të përshtatem", - tha

admirali. Këto janë kohë sfiduese, kohë të pasigurisë së madhe, por ne si aleatë jemi të forcuar nga njohuria se ka 3.2 milionë ushtarakë dhe gra (së shpejti më shumë) që do të bëjnë gjithçka që është e nevojshme për të mbrojtur çdo centimetër të territorit aleat dhe secilin nga 1 miliardë qytetarë që jetojnë në tokën aleate. Është detyrë solemne e shefave të mbrojtjes që të sigurohen se ata janë në gjendje të përmbushin detyrën e tyre të rëndësishme në mënyrën më të mirë të aftësive të tyre. Ne u shërbejmë atyre, ashtu si ata i shërbejnë Aleancës sonë".

Një Estoni më e fortë do të thotë një NATO më e fortë

Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s vlerësoi Estoninë për qëndrueshmërinë dhe inovacionin e saj dixhital. Ai tha se vendndodhja e kësaj ceremonie mikpritëse simbolizon forcën më të rëndësishme të Estonisë: "Lidhjen si një nga portet më të mëdha dhe më të ngarkuara të pasagjerëve në rajonin e Detit Baltik, ajo lidh njerëzit nga veriu, lindja, jugu dhe perëndimi. Me arkitekturë të bukur të shekullit të 13-të deri në 16-të dhe lehtësia inovative portuale me prirje përpara, lidh të vjetrën me të renë. Dhe për shkak se ndodhet në një kohë kur shoqëritë dixhitale më të përparura në botë, lidh gjithashtu sisteme offline dhe online. Estonia ka një aftësi unike për të përqaftuar ndryshimin, inovacionin dhe kreativitetin. Është një vend që është i rrënjësor fort në traditat demokratike që NATO i ka për zemër. Kjo na frymëzon të gjithëve. Sidomos në një kohë kur siguria në zonën euroatlantike është nën presion të jashtëzakonshëm". Admirali Bauer në vlerësimin e tij të situatës tha se "ka nga ata që nuk kanë hequr dorë nga dëshira që e ardhmja e Europës të formësohet, jo nga vetëvendosja e lirë e kombeve, por nga e drejta e atij që është më i fortë. Është e vërtetë që Rusia rrezikon vlerat tona demokratike, çnderon historinë tonë të përbashkët dhe qëllimisht përpiqet të shkatërrojë të gjithë rendin ndërkombëtar të bazuar në rregulla. Por ka edhe kombe të lira dhe demokratike, që do të ngriheshin me çdo kusht për ta mbrojtur atë. Për të mbrojtur të drejtën sovranë të çdo personi dhe çdo kombi për të zgjedhur fatin e tij. Estonia është një komb i tillë!", - tha ai.

Tetëmbëdhjetë vjet më parë, Esto-

nia, së bashku me Letoninë, Lituaninë, Sllovakinë dhe Slloveninë ecën përmes derës sonë të hapur të NATO-s, duke u bërë pjesë e qenësishme e Aleancës më të fortë mbrojtëse në botë. Një Aleancë që për më shumë se 7 dekada ka mundur t'i kthejë ëndrrat dhe idetë në realitet. Për të njohur vlerën e të punuarit së bashku për çështje me interes të përbashkët, duke u zotuar se do t'i vijmë në ndihmë njëri-tjetrit në rast sulmi, duke bashkuar burimet, njohuritë dhe aftësitë mbrojtëse, duke ndërtuar sigurinë tonë së bashku si Kombe të Lira dhe të Pavarura. Edhe sot, ky premim i mbrojtjes kolektive, "një për të gjithë, të gjithë për një", është në thelb të NATO-s. Sot, 30 Kombet tona, së shpejti 32, janë të LIDHUR, duke shpallur se ajo që na bashkon është shumë më e madhe se ajo që na ndan, duke e kthyer diversitetin tonë në forcën tonë më të madhe dhe duke formuar grupin më të madh të vëllezërve dhe motrave në botë".

Kujtojmë se Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, admiral Rob Bauer zhvilloi një vizitë në Estoni, përpara Konferencës vjetore Ushtarake të NATO-s që u mbajt në Tallin. Gjatë vizitës së tij, ai u takua me Presidentin Alar Karis, ministrin e Mbrojtjes Hanno Pevkur dhe shefin e Mbrojtjes, gjeneraljtënant Martin Herem. Admirali Bauer udhëtoi gjithashtu në Tapa për t'u takuar me Brigadën e Parë të Këmbësorisë dhe grupin e betejës shumëkombëshe të NATO-s, Prezenca e Përparuar.

Pas një ceremonie mirëseardhjeje nga Garda e Nderit, Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, admiral Bauer zhvilloi një takim me gjeneraljtënant Herem, shef i Mbrojtjes i Estonisë për të diskutuar mjedisin aktual të sigurisë dhe konfliktin e vazhdueshëm në Ukrainë. Admirali Bauer u takua gjithashtu edhe me ministrin e Mbrojtjes të Estonisë, z. Pevkur dhe zhvilloi diskutime të përqendruara në aftësinë e Estonisë për t'u përshtatur, evoluar dhe inovuar, veçanërisht në sferën dixhitale. Admirali Bauer nënvizoi se "Estonia është një aleat shumë elastike dhe një kryesuese në zhvillimin e aftësive kibernetike. Ajo pret Qendrën e Ekselencës së Mbrojtjes Kibernetike të NATO-s dhe fondacionin CR14, i cili organizon Gamën Kibernetike të NATO-s, një platformë për stërvitje dhe trajnime kibernetike. Për më tepër, që në vitin 2023, Estonia, në bashkëpunim me Mbretërinë e Bashkuar, do të krijojë selinë europiane DIANA, duke mundësuar më tej aftësinë e NATO-s për t'u përgatitur për të ardhmen".

Admirali Bauer gjithashtu ishte në Tapa, ku u takua me trupat nga Brigada e Parë e Këmbësorisë dhe grupi luftarak shumëkombësh i NATO-s për Prezencën e Përparuar. "Isha krenar që takova burrat dhe gratë e vendosur në Tapa sot, ata përfaqësojnë më të mirën e Aleancës sonë dhe aftësinë tonë për të punuar së bashku për të mirën më të madhe. Unë pashë gjithashtu ndërrimimin midis kombeve të ndryshme, vendosmërinë e tyre të përbashkët dhe gatishmërinë e tyre të shtuar. Së bashku, ata kontribuojnë në forcimin e mburojës mbrojtëse të NATO-s në krahun tonë lindor", - nënvizoi ai. Estonia udhëheq me shembullin kur bëhet fjalë për shpenzimet e mbrojtjes, jo vetëm duke përmbushur objektivin prej 2%, por duke bërë plane për ta tejkaluar atë. Një Estoni më e fortë do të thotë një NATO më e fortë.

Vendosmëria e popullit ukrainas në mbrojtjen e vendit të tij, një frymëzim për botën

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s takon ministrin e Jashtëm të Ukrainës në Nju Jork

Në margjinat e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg takoi Ministrin e Jashtëm të Ukrainës, Dmytro Kuleba në Nju Jork të mërkurën (21 shtator 2022).

Ai tha se guximi dhe vendosmëria e popullit ukrainas në mbrojtjen e vendit të tyre kundër luftës së agresionit të Rusisë janë një frymëzim për botën. Ai theksoi se, ndërsa Presidenti Putin përshkallëzon luftën, është edhe më e rëndësishme që NATO dhe aleatët të vazhdojnë të rrisin mbështetjen për Ukrainën, në mënyrë që të mbështesin të drejtën



e saj të vetëmbrojtjes, të sanksionuar në Kartën e OKB-së. Stoltenberg e bëri të qartë se mobilizimi i pjesshëm i shpallur nga Presidenti Putin tregon se “lufta nuk po shkon sipas planit” dhe retorika e tij bërthamore ishte “e rrezikshme dhe e pamatur”.

Sekretari i Përgjithshëm u takua gjithashtu me ministrin e Jashtëm të Emirateve të Bashkuara Arabe, Sheikh Abdullah bin Zayed Al Nathan për të diskutuar zhvillimet ndërkombëtare dhe partneritetin midis NATO-s dhe Emirateve të Bashkuara Arabe.

Z. Stoltenberg takoi znj. Vjosa Osmani, Presidenten e Kosovës për të trajtuar situatën aktuale politike dhe

të sigurisë në Kosovë. Ai theksoi se misioni i KFOR-it i drejtuar nga NATO mbetet vigjilent dhe i përkushtuar për zbatimin e mandatit të tij të OKB-së. Ai ripohoi gjithashtu mbështetjen e NATO-s për dialogun e lehtësuar nga BE midis Beogradit dhe Prishtinës.

Ai u takua gjithashtu me Presidentin e Kolumbisë, Gustavo Petro, për të diskutuar zhvillimet rajonale dhe botërore, partneritetin midis NATO-s dhe Kolumbisë, si dhe përpjekjet për të adresuar sfidën e përbashkët të ndryshimeve klimatike.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I NATO-S NË ASAMBLENË E PËRGJITHSHME TË OKB-SË

Jens Stoltenberg: Referendumet e rreme nuk kanë legjitimitet dhe nuk ndryshojnë natyrën e agresionit të Rusisë ndaj Ukrainës

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg iu bashkua udhëheqësve botërorë në Nju Jork në hapjen e Debatit të Nivelit të Lartë të Sesionit të 77-të të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara më 20 shtator 2022.

Tema e këtij viti, “Një moment vendimtar: zgjidhje transformuese për sfidat e ndërlidhura”, pranon se bota është në një moment kritik për shkak të krizave komplekse dhe të ndërlidhura, duke përfshirë luftën e Rusisë në Ukrainë, pandeminë COVID-19 dhe ndryshimet klimatike.

Më 20 shtator, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s zhvilloi një takim dypalësh me presidenten moldave Maia Sandu, për të diskutuar luftën e Rusisë në Ukrainë dhe për të përsëritur mbështetjen e vazhdueshme të NATO-s për vendet partnere, përfshirë Moldavinë. Ndërsa ndodhej në Nju Jork, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s u takua dhe shkëmbeu mendime me liderë dhe zyrtarë të tjerë.

Në përgjigje të njoftimit se e vetëshpallura “Republika Popullore e Donetskut” dhe “Republika Popullore e Luhanskut” do të mbajnë referendume për t’u bërë pjesë e Rusisë, Stoltenberg tha se “Referendumet e rreme nuk kanë legjitimitet dhe nuk ndryshojnë natyrën e luftës të agresionit të Rusisë kundër Ukrainës. Ky është një përshkallëzim i mëtejshëm në luftën e Putinit. Komuniteti ndërkombëtar duhet të dënojë këtë shkelje flagrante të ligjit ndërkombëtar dhe të rrisë mbështetjen për Ukrainën.”

NATO dhe Kombet e Bashkuara ndajnë një angazhim për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare dhe kanë zgjeruar bashkëpunimin e tyre gjatë dekadës së fundit. Në fillim të këtij viti, aleatët e NATO-s miratuan Konceptin e ri Strategjik, i cili përforcoi synimin e Aleancës për të mbajtur një perspektivë globale dhe për të punuar ngushtë me partnerët, duke përfshirë organizatat ndërkombëtare.



Kërcënimi bërthamor i Putinit, përshkallëzim i rrezikshëm

“Kërcënimi i presidentit rus, Vladimir Putin, për përdorimin e armëve bërthamore pas ngecjeve të ushtrisë ruse në luftën në Ukrainë është një retorikë e rrezikshme dhe e pamatur”, - tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg. Sipas shefit të NATO-s, e vetmja mënyrë për t’i dhënë fund luftës që Rusia nisi kundër Ukrainës është që të dëshmohej se Moskë nuk do të fitojë në fushëbetje.

Stoltenberg tha në një intervistë për

“Reuters” se njoftimi i Putinit përbën mobilizimin e parë ushtarak të Rusisë që nga Lufta e Dytë Botërore. Kjo, sipas tij, do të përshkallëzojë konfliktin, që do të çojë në humbje më të mëdha të jetës. Por, shefi i NATO-s shtoi se njoftimi i Putinit po ashtu dëshmon se lideri rus ka bërë “një gabim të madh” kur ka vendosur që të pushtojë Ukrainën më 24 shkurt. Ai tha se aleanca ushtarake e NATO-s do të qëndrojë e qetë dhe nuk do të angazhohet në retorika të pamatura dhe të rrezikshme bërthamore sikurse presidenti Putin.

“E vetmja mënyrë për t’i dhënë fund kësaj lufte është të dëshmohej se presidenti Putin nuk do të fitojë në fushëbetje. Kur ai ta kuptojë këtë, ai do të detyrohet të ulet dhe të negociojë një marrëveshje të arsyeshme me Ukrainën”, - tha Stoltenberg.

Kujtojmë këtu se gjatë një adresimi më 21 shtator, Putin njoftoi se do të mobilizojë deri në 300 000 rezervistë për të luftuar në Ukrainë. Ai po ashtu mbështeti planin për të aneksuar pjesë të Ukrainës, duke lënë të kuptohet se është i gatshëm të përdorë armë bërthamore për ta mbrojtur Rusinë. “Nëse integriteti territorial i shtetit tonë kërcënohet, ne do të përdorim të gjitha mjetet e nevojshme për të mbrojtur njerëzit tanë, ky nuk është bluf”, tha Putin.

Fjalimi i Putinit erdhi pasi forcat ruse janë dëbuar nga disa zona që kishin pushtuar në verilindje të Ukrainës, pasi Kievi nisi një kundëroftensivë më herët gjatë këtij muaji.

“Fjalimi i presidentit Putin dëshmon se lufta nuk po shkon sipas planeve të tij. Ai ka bërë një gabim të madh, një gabim strategjik”, - tha Jens Stoltenberg duke iu referuar Pu-

nitit. “Përfshirja e më shumë trupave do ta përshkallëzojë konfliktin. Kjo nënkupton më shumë vuajtje, më shumë jetë të humbura, jetë të ukrainasve, jetë të rusëve”, - tha Stoltenberg. Ai tha se NATO ende nuk ka parë ndonjë ndryshim në lëvizjen apo gatishmërinë e forcave bërthamore të Rusisë dhe shtoi se është kyçe që të parandalohet një përshkallëzim i tillë. “Ne do të sigurohemi se nuk do të ketë asnjë keqkuptim në Moskë sa i përket seriozitetit të përdorimit të armëve bërthamore. Dhe për këtë arsye ne kemi qenë të qartë në komunikimet tona me Rusinë lidhur me pasojat e paprecedentë, lidhur me faktin se lufta bërthamore nuk mund të fitohet nga Rusia”.

Separatistët në katër rajonet ukrainase Donjetsk, Luhansk, Herson dhe Zaporizhja, njoftuan më 20 shtator se planifikojnë të mbajnë të ashtuquajturat referendume për t’iu bashkuar Rusisë. Ata thanë se votime të tilla do të mbahen nga 23 deri më 27 shtator. Plane për mbajtjen e votimeve të tilla janë dënuar nga Perëndimi.

“Mbretëresha Elizabeth II, shembulli i udhëheqjes vetëmohuese dhe shërbimit publik”

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s bashkohet me liderët botërorë në funeralin shtetëror të Mbretëreshës Elizabeth II

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, iu bashkua personaliteteve nga e gjithë bota në Westminster Abbey në Londër, më 19 shtator 2022, për funeralin shtetëror të Madhërisë së Saj, Mbretëreshës Elizabeth II.

Pas vdekjes së saj, Sekretari i Përgjithshëm i bëri homazhe Mbretëreshës si “një mbështetëse e fortë e Aleancës sonë transatlantike, forcave tona të armatosura dhe vlerave tona”. Ai shkroi se “Për më shumë se 70 vjet, Mbretëresha Elizabeth II ishte shembulli i udhëheqjes vetëmohuese dhe shërbimit publik.” Ai shtoi gjithashtu se “Unë gjithmonë do ta kujtoj mençurinë dhe ngrohtësinë e saj.”

Ndërsa ishte në Londër, Sekretari i Përgjithshëm u takua me Madhërinë e Tij Mbretin Charles III në Buckingham Palace. Z. Stoltenberg i ofroi ngushëllimet e tij më të thella Mbretit dhe Familjes Mbretërore, si dhe popullit aleat të NATO-s, në Mbretërinë e Bashkuar, Kanadasë dhe të Komonuelthit.

Mbretëresha Elizabeth II njihje dhe punoi me të gjithë Sekretarët e Përgjithshëm të NATO-s që nga themelimi i Aleancës. Ajo vizitoi selinë e NATO-s dhe priti liderët e aleatëve në Buckingham Palace, së fundmi më 2019. Për nder të Madhërisë së Saj, flamujt e NATO-s dhe të të gjitha vendeve aleate u ulën në gjysmështrizë në selinë e NATO-s në Bruksel.

Dimri, Donacionet dhe "Dritharmët"

- 3D në "Operacionin special"



KOLONEL HYSNI GJERGJI

"Operacioni special" nuk është aspak i kufizuar, ai është drejtuar jo vetëm në një rajon të Ukrainës, jo vetëm në Ukrainë, madje jo vetëm në Europë.

Rreziku i përdorimit të armëve bërthamore është akoma opsion, për faktin se rusët e kanë të vështirë të pranojnë humbjen dhe të tërhiqen nga operacioni i tyre "special". Egoja dhe "lëndimi" i sdrës së fituesit të përjetshëm u shfaq edhe në fjalën e tij, më 20 shtator, e cila nuk i lejon liderët autoritarë të pranojnë se po humbasin. Për të përmbysur rezultatin, diktatorët do të përdorin edhe armën e fundit të dëmtimit në masë. Më 21 shtator, Putin kërcënon se nuk po bën bluf, lidhur me përdorimin e çdo arme dhe mjeti për të mbrojtur sovranitetin dhe integritetin e kërcënuar territorial të Rusisë. Mobilizimi i "pjesëshëm" i 300 mijë rezervistëve për ditët në vazhdim, tregon se paqja është larg. Megjithatë opsioni i kërcënimit bërthamor në duar të rusëve ekziston, Moskë ka shpalosur edhe një spektër të gjerë armësh dhe rreziqesh hibride, për doktrinën e të cilave me gjasa, ka punuar kohë më parë.

"Dimri", "Donacionet" dhe "Drithi" aktualisht janë etiketuar me armët sovjetike dhe aleatët më besnikë të "ushtrisë së kuqe", në luftën e dytë botërore. Pas 80 vjetësh, ironikisht edhe një herë tjetër acari rus është drejtuar kundër Gjermanisë paqësore dhe demokratike, por jo vetëm kundër saj. I ashtuquajtur "operacion special", me armët 3D i ka dhënë efektet negative nga Europa deri në Lindjen e Mesme, Afrikë dhe vende të tjera, të cilët janë bazuar me burime energjie dhe drithi të Rusia dhe Ukraina. I bindur se i ashtuquajtur "Operacioni special" po funksionon, Putin deklaroi, më 6 shtator 2022, se Europa, nëse nuk bën marrëveshje me Rusinë, këtë dimër do të ngrijë si "bishi i ujkut", duke kujtuar një përrallë të vjetër ruse. Ndërkohë që planifikonte skenarët e krizës energjetike, Putin vazhdoi donacionet për mbështetjen e partive politike pro ruse në Europë; si dhe të kërcënohte me urinë e bukës; pikërisht tani para dimrit që po afrohet 2022-2023.

Koha kur Putin zgjodhi ta pushtojë Ukrainën është e mirë planifikuar, një moment i vështirë për njerëzimin, kohë kur Europa dhe Bota po rimëkëmben nga efektet ekonomike të pandemisë COVID 19. Pikërisht në këtë moment ai vendos të sulmojë, duke besuar se ekonomitë perëndimore nuk do të jenë në gjendje t'i përballojnë pasojat e vendosjes së sanksioneve kundër Rusisë. Ai shprehet i bindur se BE edhe kësaj radhe do të jetë e butë në dënimin e agresionit rus, ashtu siç ishte në vitin 2014 për Krimenë. Në ditët e para të agresionit, ai është përpjekur të "përkëdhelë" Gjermaninë, nga njëra anë, ndërsa të fajësojë Anglinë për pasojat në luftën e dytë botërore, me qëllim "subversion" në mes vendeve të BE-së dhe NATO-s.

Putin në strategjinë e tij është përpjekur që mbështetjen ndërkombëtare ta fitojë duke përdorur tre strategji të përkallëzuara. E para, është pa pagesë nëpërmes "fuqisë së butë", duke u bazuar kryesisht në patriotizmin, glorifikimin dhe kontributin sovjetik në luftën e dytë botërore. Për këtë qëllim përdoren nostalgjikët dhe "idiotët e dobishëm" të organizuar në shoqata miqësie dhe organizata veteranësh. Bursat e studimit për studentë nga vendet e ish-traktatit të Varshavës, janë një grup interesi për të rekrutuar mbështetës dhe fanatikë pro ruse.

Metoda e dytë është me blerje, sipas parimit që "një problem që nuk zgjidhet me para, zgjidhet me shumë para". Paratë ruse në ekonomi vadin politiken europiane dhe japin frytë të manipuluar dhe pamerituara në zgjedhje. Kremlini nuk ka kursyer të paguajë për të arritur interesat e tij strategjike, qeveri, shoqata, personalitete, individë me interes, etj. Paga të majme jepen për spiunazh, sabotazh dhe subversion drejt vendeve të Ballkanit, si objekt kryesor i interesit rus. Në fushën e financimeve të të huajve, nuk ka ligje, moral dhe mëshirë, nuk ka regjime autoritare apo demokratike, por ka "një marrëveshje" të heshtur, ku mbizotëron interesi kombëtar i çdo vendi. Afërsisht këtë e bëjnë të gjithë shtetet kundër të gjithëve. Çdo shtet kërkoi të ketë epërsi dhe kontroll mbi tjetrin. «Skandal» i fundit i financimeve ruse në Europë shpërthen në një moment vendimtar të fushatës së zgjedhjeve në Itali. Matteo Salvini është politikani i vetëm evropian që shëtiste me një bluzë me figurën e Putinit, në kohën e aneksimit të Krimës nga Moskë në 2014. Në 2018, Partia e Salvini mori vetëm 4%, dhe sot kjo parti ka 25% të votuesve. Me strategji të mirë venduar, duke joshur me çmimet më të ulëta të gazit për Europën për 10 vitet e fundit, Moskë arriti të "vërë në gjumë" sigurinë energjetike europiane në 10 vitet e fundit dhe arriti të zotërojë pa konkurrencë, i vetëm, rubinetet e gazit për disa shtete kryesore të Ballkanit dhe Europës.

Pjesë e "kurthit" të krizës së planifikuar të energjisë, ishte edhe përfshirja në bordinë të ish-kryeministrit të shteteve kryesore të Europës si Schröder i Gjermanisë, Fillon i Francës, Renzi i Italisë, Aho i Francës, Kern ish-Kancelar dhe Kneiss ish-ministre e jashtme e Austrisë; Kjo e fundit, madje e ftoi presidentin rus në dasmën e saj.

Mbështetja politike e këtyre figurave, përmes profilit, lobimit dhe aksesit të lartë politik, ishte e nevojshme për Moskën. Vetëm prezenca e emrave të tyre në forumet dhe bordet botërore të energjisë, i bëri "vetting" Putinit në sytë e opinionit botëror dhe e largoi nga dyshimi për "dyshimet" e përhapura ndaj tij. Siç mund të vlerësohet tani, ia vlejti pagesa e "pensionit të majmë" për këto ish-liderë të Europës. Të gjithë këto elita europiane, Putini i bleu me anë të kompanive ruse



që i pajtonin si administratorë. Asnjëri nga këto liderë të Europës nuk foli apo dënoi agresionin rus në Ukrainë.

Ndërhyrjet me mjete financiare të një shteti në fushatat elektorale të një shteti tjetër, janë të njohura, aq më tepër kur bëhet fjala për fuqi antidemokratike si Rusia, të cilat nuk e kanë problem të ndërhyjnë edhe me armë në një vend tjetër. Në Francë, sipas shtypit, janë financuar nga Rusia partia e Le Pen-it, e cila në dy zgjedhjet e fundit presidenciale arriti në vendin e dytë, fare afër fitores. Kina bën të njëjtën gjë në shumë vende të Afrikës dhe padyshim në Europë, ashtu si dhe Turqia në Azinë Qendrore. Vetë shtypi francez i ka përfolur disa metoda lidhesh financiare në Afrikë me shprehjen «Francafrika» për të denoncuar mbështetjen elektorale ndaj liderëve diktatorë afrikane. Aq larg shkon ironia e këtij "sporti" botëror të ndërhyrjes në lojën politike të vendeve të tjera, sa dhe vetë vendet që «sulmojnë» por edhe «sulmohen» si rasti i Francës, në të cilin Maroku që kishte arritur të fuste software spiunazh për të përgjuar celularin e presidentit Makron. Serbia në 2015 bleu «shërbimet këshillimore» të Tony Blair, atij që u akuzua pareshtur për vite me radhë, se kishte bombarduar Beogradin me 1999?! Deklarimet e fundit zyrtare të SHBA-së për donacione rreth 500 mijë dollarë për të manipuluar zgjedhjet, në drejtim të Ballkanit dhe Europës, janë bërë edhe nga vetë sekretari Blinken. «Ne jemi angazhuar me vendet në mbarë botën për të ndarë atë që dimë për ndërhyrjen e Rusisë në sistemet zgjedhore gjersisht, por edhe në raste specifike. Kur kemi informacion, përfshirë informacion inteligjence në lidhje me ndërhyrjen e Rusisë, ne shpesh e ndajmë atë informacion të klasifikuar me qeveritë partnere», - thotë zëdhënësi i Departamentit të shtetit, Ned Price, më datë 17 shtator 2022.

Mënyra e tretë është bllokada ekonomike dhe fushata e armatosur ushtarake. Kjo aplikohet nëse me "soft power" ose me "para të zeza" nuk është arritur rezultati i dëshiruar. Kjo metodë duket qartë se po ndodh në Ukrainë. BE-ja dhe SHBA-të po e fitojnë luftën në drejtim të fushatës ushtarake, por në dy elementët e tjerë: ushqimet dhe energjia, situata është kthyer në të kundërt. Rusia dhe Ukraina në tregtinë botërore për sa i përket eksporteve në drejtim të drithit, ofrojnë 29 % të eksporteve të grurit respektivisht: 17 % Rusia dhe 12 % Ukraina dhe rreth 20 % të eksporteve të misrit. Ato zhvillojnë më shumë se 50 % të eksportit të vajit të lulediellit (29 % Rusia dhe 21 % Ukraina). Në momentin kur eksporti i produkteve të rëndësishme jetësore ushqimore u ndërpre si pasojë e luftës, në Europë çmimet e grurit, misrit dhe vajit ushqimor u rritën në mënyrë të paparashikueshme. Ukraina ka një popullsi sa 5% e popullsisë botërore dhe furnizon me ushqim rreth 400 milionë banorë (e përafërt me popullsinë e SHBA-ve) si dhe rreth 80% të drithit të nevojshëm për BE-në, e cila ka rreth 500 milionë banorë. Rusia në vitin 2020 eksportonte 40 % të energjisë në Europë, e cila transportohet nëpërmjet gazsjellësit "Nord Stream 1". Ky gazsjellës është ndërtuar krejtësisht nën ujë në Detin Baltik, me gjatësi 1224 km dhe ka kushtuar 7.4 bilion euro. Është financuar së bashku nga kompania shtetërore ruse "Gazprom" me katër kompani europiane, shumica e gazit shkon në Gjermani dhe prej andej shpërndahet në të gjithë Europën.

Për të kuptuar këtë element të luftës hibride të Rusisë, duhet të krahasojmë çmimin e gazit nga muaji janar 2022 deri në shtator 2022. Çmimi i energjisë për këtë periudhë në SHBA është rritur me 37 %, në Britaninë e Madhe me 142 % dhe në BE me 144 %. Gjatë vitit 2020 vendet e BE-së kishin këto vartësi nga gasi rus: Maqedonia e Veriut 100 %, Finlanda 94 %, Bullgaria 77 %, Sllovakia 70 %, Gjermania 49 %, Italia 46 %, Polonia 40 % dhe Franca 24 % vartësi nga gasi rus. Rusia e kishte gati skenarin, sapo BE-ja vendosi sanksione ekonomike, dhe mori menjëherë dy vendime të rëndësishme: Ndalimin e eksportit të gazit në vendet e BE-së me 60 % dhe vendosjen e kushtit ata duhet të paguanin me rubla. Meqenëse Rusia ndaloj 60 % të eksportit të gazit në tregun evropian, menjëherë çmimet e gazit u rritën për shkak të kërkesës së lartë dhe rënies së ofertës me 40%. SHBA-të, Katar, Norvegjia dhe Australia, janë në gjendje të ofrojnë sasinë e nevojshme të gazit për BE-në, por ata nuk e kanë aktualisht në dispozicion infrastrukturën për transportin dhe shpërndarjen e gazit në vendet e Europës. Ndërtimi i tubacionit "Nord Stream 1" nga Shën Petërburgu në veri-lindje të Gjermanisë zgjati rreth gjashtë vite. BE-ja duhet që në bashkëpunim me fuqitë botërore të gazit si SHBA-të, Norvegjinë, Katarin, etj., të fillojnë ndërtimin e infrastrukturës, me qëllim shpërndarjen e gazit nëpër Europë dhe heqjen e vartësisë një herë e përgjithmonë nga burimet energjetike të Rusisë. Sipas EuroStat inflacioni në BE është rritur me 9.6 % në muajin qershor 2022, çmimet e prodhimeve industriale janë rritur me 36 %, çmimet e ushqimeve janë rritur me 7.5 % dhe energjia me 144 %, duke arritur shifrat më të larta të 20 viteve të fundit. Pakënaqësia e evropianëve është objektivi i Moskës, pasi Rusisë i intereson të ulë mbështetjen e votuesve pro perëndimorë dhe të rrisë trazirat, mosbesimin, koston e jetesës dhe pakënaqësitë e brendshme të BE-së.

Mediat europiane, ndër të cilat "Berlin policy journal", i janë kthyer analizave të deklarimeve dhe botimeve strategjike ruse para agresionit mbi Ukrainë, ndër të cilat është doktrina "Gerasimov", një ese prej 2

000 fjalësh, e botuar në shkurt 2013 nga gjenerali Gerasimov - shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Rusisë. Në këtë dokument kryesor strategjik të ushtrisë ruse, u theksua roli i mjeteve jo-ushtarake për arritjen e qëllimeve politike dhe strategjike. Në konfliktin aktual në të vërtetë ndikimi i gazit, naftës parave të pista dhe ushqimit, në shumë raste ka tejkaluar fuqinë e forcës së armëve në efektivitetin e tyre. Gerasimov njihet si një komandues, tankist i aftë dhe i ashpër, por karriera e tij nuk ka treguar asnjë provë se ai është edhe një teoricien ushtarak apo edhe i interesuar për studimin e artit të luftës. Doktrina konsiderohet nga shumë studiues si artikulum i strategjisë moderne të Rusisë dhe një vizion i luftës totale, që e vendos

politikën dhe luftën brenda të njëjtit spektër aktivitetesh - filozofikisht, por edhe ekonomikisht. Doktrina duket se është një nocion themelor i luftërave, që Rusia planifikon të kryejë dhe fitojë, duke nxitur propagandë, operacione të fshehta të ndikimit, kërcënime me urinë dhe ngriçen dhe "para të zeza" për të manipuluar zgjedhjet në Europë.

Është e qartë për të gjithë se motori i zhvillimit të ekonomisë, që ndikon koston e tij kudo në ekonomi, për çdo komb është energjia. Deri në muajin gusht të vitit 2022, furnizimi i Europës me gaz nga Rusia ka rënë me 80%. Kriza energjetike në Europë, ka filluar të mbyllë fabrikat një nga një. Efektet e luftës ekonomike po ndihen çdo ditë e më shumë. Afërsisht gjysma e fabrikave të aluminit dhe zinkut në Europë janë mbyllur në këtë fillim shtatori 2022. "Nyrstar" është fabrika më e madhe e prodhimit të zinkut në botë, me qendër në Holandë, që zotërohet në pjesën më të madhe nga "Trafigura", ndaloj prodhimin në shtator. Fabrika e aluminit "Damco Aluminium Delfzijl Coöperatie U.A." (ALDEL) në Delfzijl, Holandë, u mbyll javën e kaluar. Fabrika e "Damco" në Farmsum, e cila prodhon alumin me cilësi të lartë, është mbyllur nga data 1 Shtator 2022, për shkak të çmimeve të larta të energjisë. "Norsk Hydro" ASA, me qendër në Norvegji, planifikon të mbyllë fabrikën e saj të aluminit në Sllovakia në fund të muajit. Kompania sllovene e aluminit "Talum" uli prodhimin në një të pestën e kapacitetit të saj. "Alcoa" gjithashtu, një kompani me qendër në USA, do të reduktojë një linjë në fabrikën e saj Lista në Norvegji.

Kompania më e madhe në botë e plehrave kimike që ndikon në rritjen e koston të drithit drejtpërdrejt "Yara", me seli në Norvegji, bëri një ulje prej 50 për qind në prodhimin e plehrave azotike me bazë ure dhe amoniak në Europë. Prodhuesi më i madh britanik i plehrave "CF Fertilizers UK" ka njoftuar gjithashtu se do të ndalojë përkohësisht prodhimin në fabrikën e tij në Billingham. Dy prodhues të mëdhenj të plehrave në Poloni njoftuan se do të ndalojnë aktivitetet e tyre. Në fillim të gushtit, filiali Belg, "Aperam", reduktoi prodhimin në Genk dhe Charleroi. Kompania spanjolle "Acerinox" njoftoi se do të shkurtojë prodhimin dhe do të kalojë rreth 85 % të punonjësve të saj, në punë me kohë të shkurtuar. Duhet pranuar se linja e arritjes së objektivave strategjike, që ndjek Putini deri tani po funksionon. Që nga fillimi i konfliktit, Europa po vuan nga rritja e madhe e çmimeve, ndërkohë që inflacioni në drejtim të energjisë është në nivelin 41.9 %, inflacioni i ekonomisë së BE-së në muajin gusht u rrit 10.8.

Me qëllim që të kuptojmë strategjinë e luftës hibride të Putinit, duhet të analizojmë konceptin e luftës moderne së bashku me elementët e tjerë të saj hibridë, të përfshirë në këtë konflikt: Ushqimin, paratë dhe energjinë. Ndërkohë që objektivi i sanksioneve ekonomike financiare të perëndimit, është shkatërrimi i ekonomisë ruse, në fakt gjatë këtyre 7 muajve, Rusia ka grumbulluar më shumë para nga shitja e naftës dhe gazit. Kjo ka ndodhur për këto arsye se, pas ndalimit të eksportit me gaz nga Moskë me rreth 60 %, BE-ja ishte e gatshme ta paguante atë me çfarëdo çmimi, sepse mungesa e energjisë do të shkatërronte ekonominë e BE-së. Çmimet e naftës që ishin 65 \$ për fuçi në 2021, në kohë rekord shkuan 100 \$ për fuçi. Rusia përfitoi 50 bilionë dollarë në 2021, ndërsa gjatë vitit 2022 nën sanksione, gjatë të njëjtës periudhë kohe ka përfituar 90 bilionë dollarë ose rreth dyfish. Në raport me vitet e tjera, nën sanksione eksporti i sotëm i energjisë së Rusisë me të gjithë partnerët e tjerë është rritur tri herë!!

Kina dhe India nuk kanë pranuar t'i bashkohen sanksioneve ekonomike, sasia e importit të tyre edhe për shkak të një çmimi preferencial në raport me tregjet botërore, ka bërë që Rusia të shtojë volumin e eksportit me tri herë, jo vetëm duke kompensuar humbjet ekonomike me Europën, madje duke shtuar të ardhurat në buxhet. Pikërisht kjo ka qenë një nga arsyet pse SHBA-të dhe BE-ja po ushtrojnë presion mbi Indinë, që të ndalojë blerjen e energjisë nga Rusia. India është përgjigjur se është në interesin e tyre kombëtar që ta blejë energjinë sa më lirë të jetë e mundur. Shtrirja e tubacioneve në të gjithë Europën, do t'i kushtonte SHBA-ve, jo vetëm miliardë dollarë, por edhe disa vite për tu ndërtuar. Arabia Saudite nën drejtimin e Princit të Kurorës Muhammed bin Salman (MBS), vendi që eksporton më shumë naftë në botë, për shkak të marrëdhënieve të mira me Putinin, ka kundërshtuar gjithashtu kërkesën e amerikanëve për të shtuar prodhimin e naftës, ndërkohë që me rritjen e çmimit të saj gjatë këtyre pesë muajve sauditët kanë shtuar më shumë se dyfish përfitimet financiare.

Si përfundim, pavarësisht sanksioneve të forta ekonomike ndaj Rusisë, përsëri Europa edhe këtë dimër do të jetë në "mëshirën" e Rusisë sa i përket burimeve energjetike dhe ushqimorë. Për këtë arsye, gjykoj se dimri i vitit 2022, urojmë të jetë dimri i fundit i raundit të fundit të kësaj lufte ekonomike midis: SHBA-ve dhe BE-së nga njëra anë dhe Rusisë nga ana tjetër. Putini nuk e pushton me armë Europën, por me mjete të tjera hibride 3D (dimër, donacion, drithë) dhe 3S (spiunazh, subversion, sabotazh). Ai po vazhdon dhe nuk ka gjasa ta ndërpresë asnjëherë këtë luftë, sa kohë është në drejtimin e Federatës Ruse.

“Nëse nuk mund të jesh lapsi që vizaton buzëqeshjen, atëherë bëhu goma që fshin vuajtjet e tyre”

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Tek ecja trotuareve të Tiranës, zënë dorë për dore me tim bir, në krahun tim të majtë një ndërtesë me shumë dritare, por pa silueta njerëzish në të, me një derë dykanatëshe por gati statike dhe një kokë e vogël me flokët e përdredhura zgjatur lehtas me një shikim të hutuar. Një emër i madh shkruar jashtë në një tabelë “Zyber Hallulli”.

Im bir, kureshtar nga natyra, më pyet, - mami kush punon këtu?!

Fëmija i vogël gjysmë i fshehur, vazhdonte kundronte natyrën e bukur, mes dy kanatave të derës së madhe dhe një zë i fortë që vjen brenda mureve të godinës, - hyr brenda! Kurioziteti i tim biri u bë dhe më i madh pas këtij reagimi, - mami pse i bërtiti fëmijës nëna i tij?

- Biri im, “Zyber Hallulli” është shtëpia e fëmijëve që nuk i kanë prindërit pranë për shumë arsye.

Arsye?!...

Po çfarë arsye mund të justifikonin këtë fakt në sytë e djalit tim të vogël!?

Si mund të kuptojë ai se të rriturit dhe bota e nesërme për të, është plot të papritura dhe shpesh të pakëndshme!

“Jetim”, “fëmijë i braktisur”, jo, krijesë e pafajshme, është individi, prindërit e të cilët kanë vdekur, janë të panjohur, ose i kanë braktisur përkohësisht ata.

Të jesh kjo “krijesë e pafajshme” do të thotë të rritesh nga duart e dikujt tjetër, ndoshta, me shumë fat, rritesh në familje të bekuara e ndoshta të përplasesh dyerve të institucioneve, sofrave të të afërmeve, ose rrugëve të qytetit.

Ndoshta, nëse do ndërjegjësoheshim më shumë, nuk do i konsideronim këto krijesa si një barrë apo si një përgjegjësi që na ka mbetur në dorë, por si engjëj të pambrojtur që meritojnë dashuri dhe përkujdesje.

Nëse çdo mbrëmje i puthni fëmijët tuaj, dini se këto krijesa të pafajshme kalojnë vitet duke mbajtur sytë nga dritarja, duke pritur në pragun e derës, duke ëndërruar që nëna ose babai të shfaqet sikur për një moment, edhe sikur për një puthje. Sa e madhe ëndrra e tij, ah... sa e madhe, as një përqafim, as një puthje, asgjë nga ato që prindërit iu falin fëmijëve çdo ditë, vetëm se prindërit e tyre nuk janë, thjesht nuk janë për cilëndo arsye, ata janë vetëm.

Në gjithë këtë botë të madhe ata janë vetëm, dhe ne, miliona njerëz, mund të japim vetëm pak, aq pak sa për ne mund të mos jetë asgjë dhe ajo pak për këta fëmijë është jetë, është një dritë e pashuar shprese, është dashuri, dhe është përkujdesje, në këtë mënyrë ata mund të gjejnë një familje, një buzëqeshje, një ngrohtësi, një fjalë të mirë tek secili nga ne.

Ëndrra më e madhe e tyre është të mos jenë vetëm, të kenë dashuri e përkujdesje, ...sa ëndërr e madhe për ta dhe sa lehtë mund ta realizojmë ne...

Miliona fëmijë në mbarë botën jetojnë në rrugë dhe në varfëri. Shumica e këtyre fëmijëve janë të privuar nga ku-



jdese shëndetësor dhe arsimit. Ka shumë faktorë që mund t'i shtojnë fëmijët e rrugës duke përfshirë varfërinë, ndarjen e familjes, dhunën, luftërat, fatkeqësitë natyrore dhe martesat të detyruara. Të ndjekur nga dhuna, abuzimi me drogën dhe alkoolin, vdekja e një prindi, shkatërrimi i familjes, lufta, fatkeqësia natyrore ose thjesht kolapsi social-ekonomik, shumë fëmijë të varfër janë të detyruar të dalin në rrugë, të fshihen, të lypin. Shpesh në jetën e përditshme të gjithë shohim në rrugë një kategori të tillë fëmijësh. Ajo që na bën të ndjehemi keq është pamundësia jonë për ta ndryshuar këtë fakt. Shohim çdo ditë fëmijë të moshave të ndryshme që dalin në rrugë kush duke lypur, kush duke u bërë shitës ambulant për të fituar bukën e gojës.

Varfëria dhe pasiguria sociale në vendet tona dhe në mbarë botën i detyron shumë familje të heqin dorë nga prindërimi. Ata fëmijë duhet të rriten, edukohen, kulturohen dhe zhvillohen, si gjithë të tjerët.

Këta fëmijë nuk shkojnë në shkollë apo e kanë braktisur atë, sepse përdoren nga familja si faktor ekonomik apo shfrytëzohen nga “tutorët e rrugës”. Çdo ditë në rrugë dhjetëra fëmijë janë

të detyruar të lypin dhe të shesin diçka për shkak të disa detyrimeve. Disa prej tyre janë të detyruar të punojnë.

Në fakt, në të gjithë botën ka një numër të madh fëmijësh që mbijetojnë në rrugë, në disa vende ata janë më të njohur si të pastrehë. Duke ecur nëpër rrugët, qendrën e qytetit ku jetojnë shohim njerëz që kërkojnë lëmshë nga ne, të mbështjellë me një batanije, në sytë e tyre dhe fytyrat e tyre nuk sheh gëzim, këmbëzbathur verë e dimër. Nga çantat ose xhepat tanë gjithmonë iu japim monedha edhe pse ata nuk i mban gjallë. Shumë njerëz janë kundër dhënies së parave për lypësit rrugës. Ne shohim shumë fëmijë duke lypur në rrugë në gjendje të vështirë dhe të pambrojtur. Ndihe mi të trishtuar, ndonjëherë neglizhojmë duke menduar përtej qëllimit tonë. Është vërtetë shumë trishtuese...

REZULTATI I TRISHTUAR

Dhe në shtëpitë e fëmijëve, në dukje të sigurt, ku disiplina është rruajtur, ka raste të vëzhguara flagrante të abuzimit. Tek këta fëmijë, nëpër këto qendra duhen dhënë të paktën konceptet themelore të jetës në shoqëri.

Shumë fëmijë nga shtëpia e fëmijës,

të cilët rriten pa thelbin shpirtëror dhe moral, janë të prirur drejt egoizmit dhe degradimit.

Për t'u bërë anëtarë të plotë të shoqërisë është pothuajse e pamundur.

Qenia jetim i një fëmijë lë pasojë të pariparueshme psikologjike, të cilat mund të riparohen apo reduktohen vetëm në një mjedis të ngrohtë familjar dhe shoqëror, i cili e pranon dhe e sheh atë të barabartë në çdo aspekt. Në shumë raste nga studime të shumta psikologjike që i janë bërë kësaj kategorie, tek fëmijët pa prindër apo edhe vetëm me një prind, nga ana e shoqërisë vihet re një qëndrim injorues, neglizhues, ku shfaqen hapur emocionet negative që manifestohen ndaj këtij fëmije. Ky qëndrim përbën edhe shkakun fillestar që tek fëmija të lindë agresiviteti ndaj atyre që e refuzojnë, lënë pas dore, apo edhe që duan “ta heqin qafe”. Një fëmijë i tillë nuk ka fatin e pasjes së një jete normale. Ai ndjen peshën e një damke të dhimbshme sociale, refuzuese dhe dyshuese ndaj tij. Kur fëmija rritet ndjen psikologjikisht se është ndryshe nga bashkëmoshatarët e tjerë. Gjendja e një jetimi vështirësohet në stadin e adoleshencës, kur krizës së identitetit të moshës i bashkohet kriza personale që ky individ mbart në vetvete, kjo pasi origjina e identiteti personal dhe familjar nuk ekziston, duke i munguar kështu edhe objekti i identifikimit. Pikërisht identiteti i paqartë, i çrregullt dhe i shfytëruar e bën fëmijën psikologjikisht të ligsh dhe të deformuar. Për këto arsye, këta individë kanë çrregullime emocionale dhe të sjelljes.

NUK ËSHTË NJË ALTERNATIVË...

Përfundim i trishtuar: shtëpitë e fëmijës, si një formë e edukimit të jetimëve tërësisht e provuar, janë të paefektshme.

Por çfarë mund të ofrojmë në këmbim?

Ka familje strehuese që mund të zëvendësojnë familjen biologjike.

Gjithashtu interesante është përvoja e SOS, Fshatrave të Fëmijëve.

Qëllimi i tyre: sa më shumë që të jetë e mundur për të sjellë kushte të rritjes dhe edukimit të kësaj kategorie, kthimi në familje (birësuese), përkujdesje shëndetësore, avokati (për mbrojtjen e fëmijëve).

Birësimi, ky i fundit, si alternativa më e mirë e mundshme dhe në interesin më të lartë të fëmijës.

Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve përbën një nga drejtimit më të rëndësishme, të politikave të mbrojtjes sociale. Në themel të tyre, pasqyrohen parimet themelore të Konventës për të Drejtat e Fëmijëve, e ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1992, detyrimet që dalin nga objektivat e mijëvjeçarit të ri dhe instrumentet e tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar, të cilat theksojnë se: fëmijët, për shkak të veçorive të moshës, të mungesës së pjekurisë fizike dhe intelektuale, kanë nevojë për mbrojtje dhe vëmendje të veçantë nga familja dhe institucionet shtetërore. Një nga zhvillimet aktuale

sot në botë, është angazhimi i të gjithë shoqërive dhe mekanizmave të tyre qeverisës, për një botë të denjë për fëmijët, ku ata e nisin jetën në mënyrë më të mirë të mundshme, ku të gjithë ata kanë mundësi të shumta për zhvillimin e aftësive të tyre individuale në një mjedis të shëndetshëm dhe inkurajues.

Pikërisht ky mjedis, duhet të shërbejë si nxitës për zhvillimin fizik, psikologjik, shpirtëror, shoqëror, emocional dhe kulturor të fëmijëve, si një çështje që tashmë është prioritet global. Shoqëria shqiptare, është bërë pjesë e këtij angazhimi global, në realitetin e hidhur, ku një numër i konsiderueshëm fëmijësh jetojnë në kushte të rënda dhe shpesh pa mbështetjen e prindërve të tyre.

Realiteti shqiptar prezanton një shoqëri ku problemet sociale janë të mprehta, ku mirëqenia dhe mjedisi ku jetojnë janë çështje të prekura përditë, por që çdo ditë nxjerrin nevojën e ndërhyrjes shumëplanëshe shtetshoqëri, ku shtresa dhe kategori të ndryshme sociale të cenueshme, kërkojnë më shumë barazi dhe integritet me pjesën tjetër të shoqërisë.

Udhërrëfyes të pazëvendësueshëm në këtë përpjekje jetike globale për shoqëritë demokratike, mbeten parimet e interesit më të lartë të fëmijës, të mos diskriminimit, pjesëmarrjes, mbijetesës dhe zhvillimit.

Për një shoqëri të shëndetshme të së nesërme, që këto “krijesa të pafajshme” të ardhur në këtë jetë nga një raport dashuror i çastit apo jo, të rriten pranë kësaj shoqërie si pjesë e saj, me dashuri dhe vlera humane. Duhet përkushtim maksimal i institucioneve, por edhe i gjithë organizmave të tjerë, që e nesërmja mos të na përballë me të papritura të pakëndshme, pikërisht prej mos respektimit të vlerave dhe dinjitetit të kësaj pjese të shoqërisë.



AKTI EUROPIAN PËR LIRINË E MEDIAS

Komisioni European propozon rregulla për të mbrojtur pluralizmin dhe pavarësinë e medias në BE

Komisioni European miratoi një Akt European për Lirinë e Medias, një grup rregullash të reja për të mbrojtur pluralizmin dhe pavarësinë e medias në BE. Rregullorja e propozuar përfshin, ndër të tjera, masa mbrojtëse kundër ndërhyrjeve politike në vendimet editoriale dhe kundër mbikëqyrjes. Ai vë fokus në pavarësinë dhe financimin e qëndrueshëm të mediave të shërbimit publik, si dhe në transparencën e pronësisë së medias dhe shpërndarjen e reklamave shtetërore. Ai gjithashtu përcakton masat për mbrojtjen e pavarësisë së redaktorëve dhe zbulimin e konflikteve të interesit. Së fundi, ligji do të trajtojë çështjen e përqendrimeve mediatike dhe do të krijojë një Bord të ri të pavarur European për Shërbimet Mediatike, i përbërë nga autoritetet kombëtare të medias. Komisioni miratoi gjithashtu një rekomandim plotësues për të inkurajuar mbrojtjen e brendshme për pavarësinë editoriale.

Zëvendës presidentja për vlerat dhe transparencën, Vera Jourová, tha: “Ne kemi parë gjatë viteve të fundit forma të ndryshme presioni ndaj mediave. Është koha për të vepruar. Ne duhet të vendosim parime të qarta: asnjë gazetar nuk duhet të spiunohet për shkak të punës së tij; asnjë media publike nuk duhet të kthehet në kanal propagande. Kjo është ajo që ne po propozojmë sot për herë të parë ndonjëherë: masa të përbashkëta mbrojtëse për të mbrojtur lirinë e medias dhe pluralizmin në BE”.

Thierry Breton, Komisioneri për Tregun e Brendshëm, shtoi: “BE është tregu i vetëm demokratik më i madh në botë. Kompanitë e medias luajnë një rol jetik, por përballen me rënie të të ardhurave, kërcënime për lirinë dhe pluralizmin e medias, shfaqjen e platformave shumë të mëdha në internet dhe një sërë rregullash të ndryshme kombëtare. Akti European për Lirinë e Medias ofron garanci të përbashkëta në nivel të BE-së për të garantuar një pluralitet zërash dhe që mediat tona të jenë në gjendje të funksionojnë pa asnjë ndërhyrje, qoftë private apo publike. Një mbikëqyrës i ri european do të promovojë zbatimin efektiv të këtyre rregullave të reja të lirisë së medias dhe do të monitorojë përqendrimet e medias në mënyrë që ato të mos pengojnë pluralizmin.”

Asnjë ndërhyrje politike, asnjë spiun, financim i qëndrueshëm

Akti European për Lirinë e Medias do të sigurojë që mediat, publike dhe private, të mund të operojnë më lehtë përtej kufijve në tregun e brendshëm të BE-së, pa presione të panevojshme dhe duke marrë parasysh transformimin dixhital të hapësirës mediatike.

Mbrojtja e pavarësisë editoriale. Rregullorja do t'u kërkojë shteteve anëtare të respektojnë lirinë efektive editoriale të ofruesve të shërbimeve mediatike dhe të përmirësojnë mbrojtjen e burimeve gazetareske. Për më tepër, ofruesit e shërbimeve mediatike do të duhet të sigurojnë transparencën e pronësisë duke bërë publike një informacion të tillë dhe të marrin masa me synimin për të garantuar pavarësinë e vendimeve individuale editoriale.

Asnjë përdorim i spyware kundër medias. Akti për Lirinë



e Medias përfshin masa mbrojtëse të forta kundër përdorimit të spyware kundër mediave, gazetarëve dhe familjeve të tyre.

Mediat e pavarura të shërbimit publik, aty ku ekzistojnë media të shërbimit publik, financimi i tyre duhet të jetë adekuat dhe i qëndrueshëm, në mënyrë që të sigurohet pavarësia editoriale. Kreu dhe bordi drejtues i mediave të shërbimit publik do të duhet të emërohen në mënyrë transparente, të hapur dhe jo diskriminuese. Ofruesit e mediave të shërbimit publik duhet të ofrojnë një mori informacionesh dhe opinionesh, në mënyrë të paanshme, në përputhje me misionin e tyre të shërbimit publik.

Testet e pluralizmit të medias. Akti i Lirisë së Medias kërkon që shtetet anëtare të vlerësojnë ndikimin e përqendrimeve të tregut të medias në pluralizmin e medias dhe pavarësinë editoriale. Ai gjithashtu kërkon që çdo masë legjislative, rregullatore ose administrative e marrë nga një Shtet Anëtar që mund të ndikojë në media të jetë e justifikuar dhe proporcionale.

Reklamimi transparent shtetëror. Ligji për Lirinë e Medias do të vendosë kërkesa të reja për ndarjen e reklamave shtetërore në media, në mënyrë që ajo të jetë transparente dhe jo diskriminuese. Akti do të rrisë gjithashtu transparencën dhe objektivitetin e sistemeve të matjes së audiencës, të cilat kanë një ndikim në të ardhurat nga reklamat e mediave, veçanërisht në internet.

Mbrojtja e përmbajtjes së medias në internet. Bazuar në Aktin e Shërbimeve Dixhitale, Ligji për Lirinë e Medias përfshin masa mbrojtëse kundër heqjes së pajustificuar të përmbajtjes mediatike të prodhuar sipas standardeve profesionale. Në rastet që nuk përfshijnë rreziqe sistematike si dezinformimi, platformat shumë të mëdha në internet që synojnë të heqin disa përmbajtje ligjore mediatike

që konsiderohen në kundërshtim me politikat e platformës do të duhet të informojnë ofruesit e shërbimeve mediatike për arsyet, përpara se një heqje e tillë të hyjë në fuqi. Çdo ankesë e paraqitur nga ofruesit e shërbimeve mediatike do të duhet të përpunohet me përparësi nga ato platforma.

E drejta e përdoruesit të ri për të personalizuar ofertën e medias. Akti i Lirisë së Medias do të prezantojë të drejtën e personalizimit të ofertës së medias në pajisjet dhe ndërfaqet, siç janë televizorët e lidhur, duke u mundësuar përdoruesve të ndryshojnë cilësimet e paracaktuara për të pasqyruar preferencat e tyre.

Propozimi shoqërohet nga një Rekomandim që përcakton një sërë praktikash më të mira vullnetare të mbledhura nga sektori dhe të orientuara drejt promovimit të pavarësisë editoriale dhe transparencës më të madhe të pronësisë. Rekomandimi ofron një kuti mjetesh, masash vullnetare që kompanitë e medias duhet të marrin në konsideratë, të tilla si kushtet për krijimin e pavarur të përmbajtjes editoriale, përmes fuqizimit të gazetarëve për të marrë pjesë në vendime të rëndësishme për funksionimin e organeve të medias, deri te strategjitë për sigurimin e stabilitetit afatgjatë të lajmeve, prodhimin e përmbajtjes.

Një mbikëqyrës european për lirinë e medias

Komisioni propozon krijimin e një Bordi të ri European të pavarur për Shërbimet Mediatike, i përbërë nga autoritetet kombëtare të medias. Bordi do të promovojë zbatimin efektiv dhe të qëndrueshëm të kornizës ligjore të BE-së për median, në veçanti duke ndihmuar Komisionin në përgatitjen e udhëzimeve për çështjet rregullatore të medias. Ai gjithashtu do të jetë në gjendje të nxjerrë opinione mbi masat dhe vendimet kombëtare që ndikojnë në tregjet e medias dhe përqendrimet e tregut mediatik.

Bordi do të koordinojë gjithashtu masat rregullatore kombëtare në lidhje me mediat jashtë BE-së që paraqesin rrezik për sigurinë publike për të siguruar që ato media të mos anashkalojnë rregullat e zbatueshme në BE. Bordi do të organizojë gjithashtu një dialog të strukturuar midis platformave shumë të mëdha në internet dhe sektorit të medias për të promovuar aksesin në oferta të ndryshme mediatike dhe për të monitoruar përputhjen e platformave me nismat vetëregulluese, siç është Kodi i Praktikave të BE-së për Dezinformimin.

Hapat e ardhshëm

Tani i takon Parlamentit European dhe Shteteve Anëtare të diskutojnë propozimin e Komisionit për një Rregullore sipas procedurës së zakonshme legjislative. Pasi të miratohet, ai do të jetë drejtpërdrejt i zbatueshëm në të gjithë Bashkimin European. Komisioni do të inkurajojë diskutime, veçanërisht si pjesë e Forumit European të Mediave të Lajmeve, mbi praktikat vullnetare nga kompanitë mediatike të lidhura me Rekomandimin shoqëruar.

Samiti i Transformimit të Arsimit - Mbështetja e BE-së për arsimin

Samiti i OKB-së për Transformimin e Arsimit është një moment kyç për trajtimin e krizës në financimin e arsimit global, veçanërisht në vendet më të cenueshme.

Bashkimi European luan një rol udhëheqës në arsimin global, duke përfshirë rritjen e investimeve nëpërmjet “Global Gateway” dhe një angazhim të fortë për edukimin në raste urgjente. BE-ja i bën thirrje komunitetit ndërkombëtar të bëjë të njëjtën gjë dhe të investojë më shumë, në mënyrë më të barabartë dhe më efektive.

Kriza globale në arsim

Një numër kritik fëmijësh në mbarë botën nuk janë në gjendje të përfitojnë nga një arsim cilësor, kuptimplotë dhe modern.

- COVID-19 ndikoi në arsimin e 1.7 miliardë fëmijëve.
- 460 milionë prej tyre nuk kishin akses në mësimin në distancë.
- 222 milionë fëmijë dhe të rinj të prekur nga kriza janë në nevojë për mbështetje urgjente arsimore.
- 70% e fëmijëve të shkollave fillore të vendeve me të ardhura të ulëta dhe të mesme tani u mungojnë aftësitë bazë të leximit.
- Rreth 150 milionë vajza janë



jashtë arsimit - 20 milionë më shumë se përpara COVID-19.

Më shumë se 200 miliardë dollarë fonde shtesë vjetore nevojiten në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme për të siguruar arsim cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë dhe për të promovuar mundësitë e të mësuarit gjatë gjithë jetës për të gjithë.

Përkushtimi i “Team Europe” në transformimin e arsimit

Investimi në arsim është thelbësor për paqen, prosperitetin dhe mirëqenien e njerëzve dhe të planetit.

Çdo vit shtesë arsimimi rrit të ardhurat e një personi me 10% dhe rrit GDP-në e një vendi me 18%.

Si “Team Europe”, BE-ja dhe Shtetet

Anëtare të saj janë investitori i vetëm më i madh global në arsim, duke përfaqësuar 55% të granteve arsimore të Asistencës Zyrtare për Zhvillim.

Një pjesë integrale e strategjisë “Global Gateway”, veprimi i BE-së për të transformuar arsimin në të gjitha nivelet, fokusohet në: ofrimin e arsimit cilësor, duke përfshirë trajnimin e mësuesve; sigurimin e barazisë në akses, duke përfshirë edhe rrethana krize; nxitjen e aftësive për jetën dhe punësimin; lehtësimin e lëvizshmërisë së studentëve, stafit, mësuesve dhe të kursantëve.

Të paktën 10% e financimit të BE-së për partneritetet ndërkombëtare me Afrikën, Amerikën Latine, Karaibet,

Azinë dhe Paqësorin për 2021-2027 do t'i kushtohet arsimin.

BE-ja gjithashtu do të vazhdojë të angazhohet, si prioritet, me Ballkanin Perëndimor, Turqinë dhe rajonet e fqinjësisë për:

- forcimin e sistemeve të arsimit dhe trajnimit,
- adresimin e mospërputhjes së aftësive me tregun e punës,
- rritjen e bashkëpunimit të përbashkët me institucionet arsimore, duke përfshirë lëvizshmërinë e nxënësve dhe mësuesve.

E ardhmja e Ukrainës fillon në klasa dhe BE-ja do të sigurojë 100 milionë euro për të mbështetur rehabilitimin e shkollave të dëmtuara ukrainase.

Buxheti i ndihmës humanitare i BE-së ndan 10% për arsimin në raste urgjente për: mbështetje për aksesin në arsim për fëmijët e prekur nga zhvendosja dhe krizat; forcimin e mësimin e sigurt dhe cilësor; mbrojtjen e arsimit nga sulmet; rritjen e gatishmërisë dhe nxitjen e cilësisë së arsimit në reagimin ndaj emergjencave.

Qasja e BE-së për adresimin e nevojave arsimore të fëmijëve gjatë dhe pas emergjencave kombinon përpjekjet humanitare, zhvillimore dhe paqe-ndërtuese. BE-ja dhe Shtetet Anëtare, si “Team

Europe” (Ekipi i Europës), kontribuojnë dy të tretat e buxhetit të fondit “Arsimi nuk mund të presë”. Vetëm në vitin 2021, fondi përfshiu gati katër milionë fëmijë në 32 vende të prekura nga kriza.

Partneriteti Global për Arsimin

Fuqizimi i vajzave dhe grupeve të cenueshme nëpërmjet arsimit është çelësi për frenimin e rritjes së pabarazive dhe përsheptimin e progresit drejt barazisë gjinore.

“Team Europe” është kontribuuesi më i madh në Partneritetin Global për Arsimin (GPE) me 1.7 miliardë euro për të transformuar sistemet arsimore dhe për të ofruar arsim bazë cilësor të mirë për të gjitha vajzat dhe djemtë në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të barabartë.

ERASMUS+ është programi kryesor i Bashkimit European për arsimin, trajnimin, rininë dhe sportin që promovon lëvizshmërinë e të mësuarit, bashkëpunimin institucionel, ndërtimin e kapaciteteve dhe të mësuarit nga bashkëmoshatarët. Ai mbështet Zonën Europiane të Arsimit dhe përmban një dimension global që kontribuon në forcimin e lidhjeve midis BE-së dhe pjesës tjetër të botës.

Si do të përparojë teknologjia deri në vitin 2050

Deri në vitin 2050, kompanitë e mëdha të teknologjisë do të kenë nisur projekte zyrtare për të zhvilluar inteligjencën e parë artificiale të përgjithshme në botë. Miliarda dollarë do të investohen në këto projekte dhe një staf i madh me kohë të plotë do t'i përkushtohet kësaj përpjekjeje. Këto projekte shumë komplekse pritet të zgjasin nga 10 deri në 20 vjet për t'u përfunduar.

Shkencëtarët dhe inxhinierët po kuptojnë se si të modelojnë faktorët e tillë si: Kreativiteti i qëllimshëm; Të menduarit strategjik; Emocionet; Arsyetimi i rastësishëm; Mendje e shëndoshë; Të menduarit kundër fakteve; Vetëdija.

Rasti i menjëhershëm i përdorimit është të kesh një Inteligjencë Artificiale (Artificial Intelligence - AI) të vetëdijshme, me të cilën institucionet mund të konsultohen për të zgjidhur problemet që më parë konsideroheshin të pamundura.

Një rast tjetër përdorimi përfshin transferimin e kopjeve të kësaj Inteligjence Artificiale te robotët humanoidë të avancuar që mund të trajtojnë situata të ndryshme në botën reale.

Ky zhvillim parashikohet të çojë në teknologji që nuk dallohen nga magjia në dekadat e ardhshme, veçanërisht kur kombinohen me fuqinë llogaritëse në rritje eksponenciale të kompjuterëve klasikë dhe kuantikë. Megjithatë, ajo e lë të hapur derën për një AI super inteligjente që është duke u zhvilluar nga fundi i shekullit. Nuk ka asnjë kufi të realizueshëm se sa inteligjente mund të bëhet kjo AI. Një AI e tillë mund të jetë më e zgjuar se të gjithë njerëzit që kanë jetuar ndonjëherë në planetin tokë. Menjëherë pas kësaj, ajo mund të bëhet trilionë herë më inteligjente se kaq.

Robotë të ngjashëm me njeriun

Në vitin 2050, robotët do të kenë aftësinë për të zotëruar mjediset e botës reale dhe një gamë gjithnjë e më të larmishme objektivash 3D. Ata mund të përshtaten me situata të reja dhe të zgjidhin probleme gjithnjë e më dinamike. Ata mund të mësojnë nga përvojat e tyre dhe të ndajnë njohuri me njëri-tjetrin për shkak të shpejtësisë së internetit me valë mijëra herë më të shpejta se 6G dhe sasive në rritje eksponenciale të të dhënave që mbledhen nga sensorët e tyre.

Këta robotë mund të identifikojnë objektet, situatat dhe veprimet që duhet të kryejnë më pas në pothuajse kohë reale, gjë që mundëson një përgjigje më të ngjashme me njeriun. Edhe pse ende mbeten disa pengesa teknologjike dhe shkencore, kjo po i afrohet asaj që shumë njerëz do ta konsideronin inteligjencën e përgjithshme artificiale.

Robotët më të avancuar do të jenë të kufizuar në institucionet qeveritare, korporative dhe kërkimore dhe familjet e të pasurve dhe të famshmëve. Përveç aftësive njohëse, këta robotë më të avancuar do të kenë pamje jashtëzakonisht të gjallë, shprehje të fytyrës dhe gjuhën e trupit. Falë reagimeve të vazhdueshme emocionale nga përdoruesit dhe teknikave të tilla si kapja e lëvizjes dhe rrjetet gjeneruese kundërshtare, këta robotë pothuajse do të duken dhe veprojnë si njerëz të vërtetë. Dhe ndërsa më shumë të dhëna do t'u jepen këtyre robotëve, gjuha e trupit dhe lëvizjet e tyre do të bëhen më të natyrshe me çdo brez.

Kockat e printuara 3D dhe materialet e reja të zhvilluara për lëkurën dhe muskujt, sy dhe dhembë më fleksibël do të ndihmojnë që robotët humanoidë të duken sa më shumë si njerëz që të jenë e mundur.

Për më tepër, modelet më pak të avancuara do të jenë relativisht të zakonshme në shoqëri. Ata do të jenë të popullarizuar mes njerëzve në grupet me të ardhura të mesme - të larta dhe do të jenë të ngjashme në kosto me një makinë të dytë ose një blerje të ngjashme të madhe. Funkcionet e tyre do të përfshijnë punët e shtëpisë si pastrimi, gatimi dhe rregullimi, si dhe kujdesi për fëmijët dhe anëtarët e moshuar të familjes.

Qytetet "smart"

Në vitin 2050, një përqindje e vogël e qyteteve në disa rajone do të jenë bërë qytete "smart". Këto qytete inteligjente do të lidhin automjetet në rrugë me një rrjet qendror që gjurmon vendndodhjet e tyre në kohë reale. Këto lloj rrjetesh marrin terabajtë me informacion nga një numër i madh burimesh si sensorë të rrugëve, semaforët, e kështu me radhë. Këto burime ofrojnë informacione të tilla si numri i makinave në rrugë, bllokimet e rrugëve, modelet e motit, shërbimet e gjendjes së emergjencës dhe më shumë.

Automjetet autonome në rrugë do të komunikojnë dhe do të koordinohen vazhdimisht me njëra-tjetrën për të optimizuar fluksin e trafikut në këto qytete. Falë këtij shkëmbimi të koordinuar informacioni, bllokimet e trafikut do të jenë bërë shumë më pak të rënda në qytetet e mëdha. Mjetet autonome do të lëvizin pas njëra-tjetrës në një distancë prej vetëm 20 centimetrash, gjë që kursen hapësirë në rrugë. Dhe për shkak të këtij koordinimi, automjetet autonome bëjnë kthesa në kryqëzime me shpejtësi pothuajse të plotë me një probabilitet të ulët të aksidenteve.

Parkimi manual i automjeteve do të jetë një gjë e së kaluarës për pronarët e automjeteve autonome. Automjetet autonome mund të programohen për t'i lënë pronarët e tyre diku dhe më pas të kërkojnë për vendet më të lira dhe të disponueshme të parkimit brenda një qyteti. Në një kohë të caktuar, automjetet do të kthehen të marrin pronarët e tyre.

Automjetet autonome gjithashtu mund të kontrollohen nga distanca, duke përdorur pajisje të realitetit virtual. Kjo ndihmon në situata unike që AI nuk është në gjendje t'i trajtojë vetë, siç janë fatkeqësitë e papritura natyrore.

Ndërfaqet tru-kompjuter do të jenë përmirësuar

Në vitin 2050, ndërfaqet tru-kompjuter do të jenë përmirësuar shumë në krahasim me versionet e vitit 2030 dhe ato do të jenë kryesisht të përdorshme për qëllime të përditshme. Shiritat e kokës dhe shiritat e kyçit të dorës me sensorë jo invazivë do të jenë bërë zgjedhjet e preferuara për përdorimin e zakonshëm të ndërfaqes tru-kompjuter. Këto ndërfaqe do të jenë zakonisht aksesore standardë për kufjet e realitetit virtual, duke përfshirë helmetat VR (Virtual Reality)



me çmim të lartë që ofrojnë përvoja të plota të zhytjes në VR. Disa ndërfaqe truri-kompjuter do të jenë plotësisht të implantueshme për qëllime mjekësore dhe ushtarake.

Ndërfaqet tru-kompjuter do të ofrojnë një shkëmbim informacioni dydrejtësh. Këto ndërfaqe nervore të avancuara dërgojnë valë në tru, duke transmetuar ndjesi vizuale, audio dhe të tjera tek përdoruesi. Imazhet dhe përvojat e krijuara nga këto pajisje janë pothuajse të padallueshme nga realiteti dhe ato janë unike për çdo përdorues, sepse varen nga struktura e trurit.

Kur bëhet fjalë për argëtimin, njerëzit do të mund të përdorin ndërfaqet tru-kompjuter për të kontrolluar objektet në video-lojërat dhe mjediset virtuale me saktësi të lartë.

Për më tepër, këto pajisje do të lejojnë njerëzit në lojëra dhe përvoja të VR të komunikojnë me njëri-tjetrin duke përdorur mendime relativisht të thjeshta. Megjithatë, do të duhen disa dekada të tjera përpara se kjo veçori të rafinohet.

Ashensorët hapësinorë

Në vitin 2050, do të jenë ndërtuar dy ashensorë hapësinorë dhe që do të jenë projektet më të mëdha inxhinierike të ndërmarrja ndonjëherë.

Këta ashensorë hapësinorë janë sisteme transporti nga planeti në hapësirë, secili prej tyre ka një kablo të ankoruar në sipërfaqen e tokës dhe që shtrihet në hapësirë. Ky dizajn do të lejojë që një ashensor të udhëtojë përgjatë kablos direkt në orbitë, pa përdorimin e raketave të mëdha. Ato do të jenë të vendosura pranë ekuatorit të tokës dhe forcat konkurruese të gravitetit dhe forcës centrifugale të jashtme do t'i mbajnë kablollat nën tension. Materiali i përdorur për krijimin e kabllave do të jenë nanotubat e karbonit, të cilët janë të lehtë dhe qindra herë më të fortë se çeliku. Këta ashensorë hapësinorë do të përdoren shpesh nga institucionet për të dërguar ngarkesën në hapësirë dhe për të kthyer ngarkesën në tokë. Ata do të jenë gjithashtu të aftë të transportojnë astronautë dhe turistë në stacione hapësinore me orbitë të ulët.

Turizmi hapësinor

Sipas "Business Insider", turizmi hapësinor mund të jetë i realizueshëm në vitin 2050, por ka të ngjarë vetëm për ata që janë shumë të pasur. Kompanitë e raketave si "Blue Origin" e Jeff Bezo-s dhe "SpaceX" e Elon Musk do ta shtojnë rezervimin për udhëtimin në hapësirë deri sa turizmi të jetë i realizueshëm në vitin 2050.

Për shembull, dikush që mund të përballojë të paguajë 100 milionë dollarë mund të kalojë një javë në orbitë... por do të ishte vetëm për njerëzit e pasur në vitin 2050.

Marsi do të ketë një prani të përhershme njerëzore

Në vitin 2050, një ekip i përhershëm shkencëtarësh dhe inxhinierësh robotikë do të jetë i pranishëm në Mars. "SpaceX" po udhëheq pjesën më të madhe të kësaj përpjekjeje. Dhe do të kenë shkuar edhe turistë e parë civilë.

Inovacionet të rëndësishme në sistemet autonome robotike të minierave janë të nevojshme përpara se njeriu i parë të vërë këmbën në Mars. Robotët autonomë të minierave do të minojnë dhe krijojnë ujë. Robotët autonomë gjithashtu do të nxjerrin hidrogjen nga uji për të krijuar karburant me bazë hidrogjeni. Dhe satelitët që përmbajnë panele diellore rreth Marsit do të sigurojnë energji edhe për bazën e Marsit. Kjo bazë së shpejti do të zgjerohet me objekte shtesë që ofrojnë më shumë energji, prodhim ushqimi, sisteme riciklimi, pajisje minerare dhe mjete të tjera. Automjetet furnizohen gjithashtu, duke u mundësuar shkencëtarëve të bredhin qindra milje.

Syzet VR do të zëvendësojnë telefonat inteligjentë

Kufjet e realitetit virtual në vitin 2050 do të kenë rezolucion 16k dhe do të jenë zvogëluar në madhësi aq shumë sa që do të ngjajnë me syze. Ato do të kenë mënyra të shumta të shfaqjes. Këto mënyra të shfaqjes përfshijnë: Modaliteti i realitetit të shtuar lejon që lentet të jenë transparente në mënyrë që të mund të shikoni hologramet; Modaliteti i realitetit të përzier lejon që lentet të jenë gjithashtu transparente në mënyrë që të mund të shikoni objekte virtuale hiper-realiste në botën reale që duket se u binden ligjeve të fizikës; Modaliteti i realitetit virtual ka një shtresë të errët argjendi mbi syze, në mënyrë që të mund

të zhyteni plotësisht në një botë virtuale

Në mënyrat e realitetit të shtuar dhe të përzier, mund të shikoni një transmetim inteligjent ku mund të manipuloni shumë aplikacione dhe skedarë duke përdorur aktivitetin tuaj të trurit. Është për shkak të këtyre veçorive që syzet VR konsiderohen si hapi tjetër i evolucionit pas smartfonëve. Megjithatë, shumë njerëz do të vazhdojnë të preferojnë telefonat inteligjentë. Lentet e kontaktit VR dhe realiteti i shtuar janë fusha të tjera që do të adoptohen gradualisht.

Realiteti i shtuar dhe i përzier do të jetë kudo

Qytete të tëra do të jenë kthyer në zona të realitetit të shtuar, të cilat mund të përjetojnë duke përdorur syze, lente ose pajisje të tjera të realitetit të shtuar. Mbivendosjet e realitetit të shtuar për vendndodhjen specifike do të krijojnë nga korporata dhe krijues individualë. Peizazhet urbane do të jenë të mbushura me informacione të të gjitha llojeve, të cilat do të mund të filtrohen sipas nevojës duke përdorur aplikacione të realitetit të shtuar.

Etiketat e çmimeve në dyqane, menutë në restorante dhe oraret në stacionet e transportit publik do të jenë bërë të gjitha virtuale.

Do të jetë bërë gjithashtu i zakonshëm përdorimi i realitetit të shtuar për të aksesuar navigimin nga një vend në tjetrin, për të marrë komente për institucionet aty pranë dhe për të parë animacione dhe video të dukshme 3D të ngjarjeve të kaluara në vende të caktuara.

Në vitin 2050, video-lojërat do të jenë fotorealiste

Video lojërat po bëhen tepër realiste. Përparimet në motorët e lojërave dhe softuerët për ndërtimin e botës e bëjnë më të lehtë dhe më të shpejtë se kurrë për studiot e lojërave dhe krijuesit e pavarur që të ndërtojnë botë virtuale të mëdha dhe realiste. Qytetet brenda këtyre botëve do të jenë plotësisht të eksplorueshme.

Krijuesit e avancuar të personazheve do ta bëjnë relativisht të lehtë ndërtimin e qindra personazheve unikë, të paluajtshëm në një kohë që secili do të ketë një personalitet unik dhe histori jete.

Rrjetet gjeneruese kundërshtare (GANs) mund të gjenerojnë një larmi pothuajse të pafund të çdo atributi fizik si fytyrat, flokët, llojet e trupit dhe veshjet. Kjo do të jetë bërë e mundur për shkak të sasive të mëdha të të dhënave vizuale që do të furnizohen në këto rrjete. Kjo teknikë do të përmirësojë gjithashtu gjestet, shprehjet dhe veprimet e personazheve, duke i bërë ato më të gjalla. Në këtë fazë, animacionet e personazheve nuk do të jenë ende 100% realiste, por do të jenë tepër afër.

Asistentët virtualë do të kenë zëvendësuar kryesisht motorët e kërkimit

Shumë përpara vitit 2050, shumica e njerëzve në tokë do të kenë akses në një asistent virtual. I njëjti asistent virtual mund të jetë i disponueshëm si një hologram i realitetit të shtuar, karakter i realitetit virtual dhe robot shtëpiak. Dhe i njëjti asistent virtual mund të jetë i disponueshëm si zë në një shtëpi "smart", brenda një automjeti, nga një orë "smart" dhe nga një smartphone.

Këta asistentë virtualë do të jenë trajnuar mbi të dhënat e tekstit nga shumica e faqeve të internetit dhe publikimeve të krijuara në historinë njerëzore. Kështu që ata do të mund t'i përgjigjen pothuajse çdo pyetjeje që ne do t'i bëjmë. Dhe përgjigjet e tyre do të jenë të personalizuar bazuar në qëllimet, interesat përkatëse.

Ata vazhdimisht do të parashikojnë se çfarë mund të duam të bëjmë më pas dhe do të bëjnë sugjerime gjatë çdo dite në vend që ne të na duhet të shkruajmë fraza në motorët e kërkimit. Sa herë që ne kërkojmë për informacion, ata gjithmonë bëjnë sugjerime shtesë që janë të lidhura në mënyrë të paqartë me pyetjet tona për të na ndihmuar të marrim perspektiva të dobishme që nuk i kemi konsideruar kurrë.

Ne gjithashtu do të mund të personalizojmë paraqitjet, zërat dhe aftësitë e veçanta të këtyre asistentëve virtualë.

Në dekadat e ardhshme, inteligjenca e përgjithshme artificiale do ta çojë këtë teknologji në një nivel tjetër.

Një person mesatar do të ketë qasje në teknologjinë kuantike kompjuterike

Për 10-15 vitet e fundit, kompanitë e teknologjisë do të kenë ofruar teknologji të informatikës kuantike me shërbimet e tyre cloud me një kosto të moderuar deri në të lartë. Kompjuterët dhe serverët personalë do të përmbajnë gjithashtu një hibrid të teknologjisë kompjuterike klasike dhe kuantike ose një nga ato teknologji. Teknologjia kuantike do të jetë shumë më e shtrenjtë.

Kompanitë dhe individët do të përdorin teknologjinë kuantike për: të modeluar ndërveprimet e molekulave dhe atomeve; për të shpikur materiale të reja; për të krijuar objekte virtuale komplekse që janë të vështira për t'u konceptuar nga njerëzit; për të zhvilluar ilaçe të fuqishme; për të zhvilluar bateri të automjeteve elektrike me rreze të lartë që i bëjnë automjetet me bazë benzine të vjetruara.

Disa organizata do të përdorin kompjuterët kuantikë më të avancuar në botë për të simuluar nga afër proceset e trurit të njeriut. Kjo do ta bëjë një mundësi reale transferimin e kujtimeve nga njerëzit te makinat. Këto simulime do të ndihmojnë gjithashtu që inteligjenca e përgjithshme artificiale të bëhet realitet.

Leku, kartëmonedha jonë kombëtare njëshekullore

Në shkurt 1922 u bë, për herë të parë në mënyrë ligjore, emërtimi i monedhës zyrtare shqiptare "Lek".

Ajo që ndodhi në Shqipëri në seancën e shkurtit të vitit 1922 në fakt ishte krijimi i një njësie të re monetare, pasi nuk u shfuqizua franga por paralelisht u krijua një njësi e re monetare e emërtuar "Lek".

Situata do të vijonte të ishte e tillë deri në vitin 1947, kur u miratua dekretligji që hoqi nga qarkullimi kartëmonedhat franga ari. Në këtë mënyrë, njësia bazë e monedhës në vend do të caktohej Leku.

Ky emërtim thuhet se është bërë në nderim të Aleksandrit apo Lekës së Madh.

Sipas bisedimeve parlamentare në 1922 propozimet alternative kanë qenë "Skënder ose Shqipe". Portreti i Aleksandrit shfaqet në pjesën e përparme të monedhës 1 lek, ndërsa pjesa mbrapa e tij e tregon atë mbi kalë.

Emri "qindarkë" rrjedh nga fjala shqipe "qind" që do të thotë një qind.



FRANGA

Midis viteve 1926 dhe 1939, emri u përdor për monedhën shqiptare të arit me vlerë 5 lekë shqiptare, e përdorshme në transaksionet ndërkombëtare.

MONEDHAT

Leku i parë

Në vitin 1926, monedhat e bronzit u paraqitën në vlerat e 5 dhe 10 qindarka leku, së bashku me nikelin 1/4 (5 centë), 1/2 dhe 1 lek si dhe monedhën e argjendtë 1,2 dhe 5 franga ari. Pjesa e përparme e frangave (monedhë) përshkruan Mbretin Ahmet Zogun. Në vitin 1935, qindarkat 1 dhe 2 prej ari dolën në qarkullim të barasvlershme me 5 dhe 10 qindarka leku. Kjo seri monedhash përshkruante motivet e veçanta neoklasike të cilat thuhet se janë ndikuar nga mbreti italian, Victor Emmanuel III, për të cilin thuhet se ka qenë një koleksionues monedhash. Këto monedha përmbajnë germën "R" dhe "V" të cilat përfaqësojnë Romën dhe Venecian.

Nën drejtimin e Benito Musolinit, Italia pushtoi Shqipërinë dhe emetoi një seri të re monedhash në vitin 1939 në vlerat 0.20, 0.50 dhe 1 lek prej materiali të çelikut të pandryshkur. Si dhe monedha argjendi 2, 5 dhe 10 lek. Monedhat dolën në qarkullim deri në 1941 dhe kanë portretin e Mbretit Italian, Victor Emmanuel III në pamjen e përparme si dhe shqiponjën italiane dhe sqeparin në pjesën e prapme.

Në 1947, pak pasi partia komuniste erdhi në fuqi, monedhat më të vjetra u tërhoqën nga qarkullimi dhe u paraqitën zinku 1/2, 1, 2 dhe 5 lekë.

Të gjitha këto përshkruanin simbolin kombëtar socialist. Kjo seri u prodhuan përsëri në 1957 dhe u përdor deri në vitin 1965 kur ndodhi edhe reforma e monedhës.

Leku i dytë

Në 1965, monedhat prej alumini (të vitit 1964) u prezantuan në vlerat 5, 10, 20 dhe 50 qindarka dhe 1 lek. Të gjitha monedhat përshkruanin emblemën shtetërore të Socializmit. Në 1969, një seri e dytë e monedhave prej alumini, me vlerë 5, 10, 20, 50 qindarka dhe 1 lek u lëshuan në kuadrin e festimeve të çlirimit nga fashizmi në 1944.

Në 1988, ndodh një ridizajnim i tretë i monedhave prej alumini 5, 10, 20, 50 qindarka dhe 1 lek. Monedha 50 qindarka dhe 1 lek ishin të njëjta në madhësi, peshë dhe paraqitje. Monedha 1 lek kishte si mbishkrim "Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë".



Leku i tretë

Në vitet 1995 dhe 1996, monedha të reja dolën në qarkullim në vlerat 1, 5, 10, 20 dhe 50 lekë për të vazhduar me 100 lekë në vitin 2000.

Monedhat përkujtimore

Në vitin 2001, 100 dhe 200 lekë dolën në qarkullim nën temën integrimi i Shqipërisë në BE dhe 50, 100, dhe 200 lekë në kujtim të 500-vjetorit të statujës së Davidit.

Në vitin 2002, 50 lekë dhe 100 lekë dolën në qarkullim në 90-vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë.

Në vitin 2003, doli në qarkullim monedha 50 lekë, në kujtim të 100-vjetorit të vdekjes së Jeronin De Radës.

Në vitin 2004, e njëjta monedhë doli në qarkullim e frymëzuar nga antikiteti shqiptar. Ato përshkruanin kostumet tradicionale të Shqipërisë dhe Dean e lashtë.

Në vitin 2005, monedha 50 lekë u lëshua në 85-vjetorin e shpalljes së Tiranës si kryeqytet.

Kartëmonedhat

Në vitin 1926, Banka Kombëtare e Shqipërisë prezantoi kartëmonedhat në vlerat 1, 5, 20 dhe 100 franga ari.

Në vitin 1939, kartëmonedhat u emetuan në vlerat 5 dhe 20 franga.

Ato u ndoqën në vitin 1944 nga kartëmonedhat 2, 5, 10 lekë dhe 100 franga.

Në 1945, Banka e Shqipërisë emetoi më shumë kartëmonedha të Bankës në vlerat 10 lekë, 20 dhe 100 franga. Kartëmonedha të rregullta u emetuan edhe gjatë vitit 1945 në vlerat 1, 5, 20, 100 dhe 500 franga. Në vitin 1947, doli Dekretligji nr. 445, datë 07.07.1947, "Mbi heqjen nga qarkullimi të bankënotave të quajtura franga dhe emetimin e një emisioni të ri", si njësi bazë e monedhës në vend të Frangut u caktua Leku.

Vulosja e parave

Në qershor të vitit 1945 do të dilte urdhëresa e posaçme mbi vulosjen e bankënotave dhe çek-monedhave të ish-Bankës Kombëtare të Shqipërisë. Në bazë të kësaj urdhërese vuloseshin bankënotat prej 20 e 100 frangash shqiptare si dhe çek-monedhat e

emetuara nga Banka Kombëtare.

Vula që u përdor kishte trajtë drejtkëndëshi e përmbante në brendësi të saj një shqiponjë me yll dhe fjalët "Banka e Shtetit Shqiptar".

Nga vulosja, përjashtoheshin vetëm bankënotat me prerje nën 20 franga shqiptare.

Vulosja e parave do të kryhej brenda një kohë të shkurtër, 10 ditë, nga data 29 qershor deri më 8 korrik 1945. Kjo ishte kohëzgjatja e vulosjes së monedhës për të gjithë vendin.

Në bazë të urdhëresës, qendrat e këmbimit të monedhave u përfshinë në tri zona me afate të caktuara.

Një zonë më vete përfshiu qendrat kryesore. Këtu bënin pjesë rrethet e qendrës së Durrësit, Beratit, Elbasanit, Gjirokastrës, Korçës, Shkodrës, Tiranës e Vlorës. Për këto rrethe, këmbimi u parashikua të kryhej nga data 4 deri më 8 korrik 1946.

Rrethet kufitare përbënin një zonë tjetër, e cila përfshinte Bilishtin, Ersekën, Vithkuqin, Konispolin, Kukësin, Libohovën, Librazhdin, Lumën, Peshkopinë, Pogradecin, Thethin, Përmetin, Sarandën, Pukën, Zerqanin dhe Delvinën.

Një zonë e tretë përfshiu rrethet Ballsh, Burrel, Fier, Gramsh,

Himarë, Kavajë, Kotë, Krujë, Lezhë, Lushnjë, Peqin, Shijak, Mirditë, Tepelenë dhe Këlcyrë.

Këmbimi i monedhave për këto rrethe u parashikua të kryhej nga data 4 deri më 8 korrik.

Ndarja e mësipërme u jepte përparësi zonave kufitare për këmbimin e monedhave të vulosura. Për këto zona u parashikua që këmbimi të fillonte më përpara e të kryhej në një afat më të shkurtër.

"Kjo kishte si synim që t'i priste rrugën hyrjes kontrabandë të bankënotave nga jashtë. Në të njëjtën kohë ndarja në zona dhe krijimi i shumë qendrave për këmbimin e bankënotave pati për qëllim që veprimi të kryhej sa më shpejt e pa pengesa të karakterit teknik e organizativ", - shkruhet në studimin ekonomik të Fishtës.

E në fakt, praktika e vulosjes nuk ishte ajo e vendosjes së parave para një vule, por shkëmbimi i tyre me para të vulosura që kishin një kurs të ri.

Vulosja e monedhave u bë në shtypshkronjën e Bankës së Shtetit dhe në 14 shtypshkronja të tjera të vendit që u mobilizuan për këtë çështje.

Më mbarimin e afatit të parashikuar, bankënotat dhe çek-monedhat që nuk do të paraqiteshin për vulosje konsideroheshin pa vlerë dhe për pasojë do të dilnin jashtë qarkullimit monetar.

Jashtë vulosjes mbeti më shumë prej 20 % të monedhës në qarkullim, e këtu bëhej fjalë edhe për bankënotat me prerje nën 20 franga shqiptare.

Ardhja e vitit 1991 do të sillte ndryshime edhe në elementet e sigurisë të kartëmonedhave, ku për herë të parë vendoset filli i sigurisë në kartëmonedhën 100 lekë.

Banka e Shqipërisë krijohet në vitin 1992 si banka qendrore e vendit. Ndër funksionet e saj kryesore, theksohet edhe roli i saj si emetuese e vetme e kartëmonedhës dhe monedhës kombëtare që ka kurs ligjor brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Që në vitin e parë të krijimit të saj, Banka e Shqipërisë nën ndikimin e ndryshimeve të mëdha socio-politike në vend, përballet me domosdoshmërinë e rritjes së sasisë së monedhës në qarkullim si dhe ndryshimin e strukturës së prerjeve të saj. Si rrjedhojë, emetimet e këtij viti kanë ndryshime në tematikën e çdo prerjeje, kjo për shkak të mos diktimit nga sistemi politik.

Gjithashtu, për herë të parë në emetimet e pasluftës, vendosen në kartëmonedha firmat e Guvernatorit dhe të Drejtorit të Departamentit të Emisionit dhe Administrimit të Parasë.



Vitet në vijim shënojnë një rritje të vazhdueshme të kërkesës së ekonomisë për para. E shtyrë nga përgjegjësia për t'iu përgjigjur më së miri kësaj kërkesë me një strukturë të përshtatshme prerjesh, Banka e Shqipërisë, gjatë vitit 1995, kreu studime për një emision të ri të monedhës dhe kartëmonedhës. Ky emision u projektua tërësisht i ri në tematikë, me një seri monedhash metalike të përbërë nga 6 prerje: 1, 5, 10, 20, 50 dhe 100 lekë. Ndërsa, seria e kartëmonedhave përbëhet nga 5 prerje: 100, 200, 500, 1000, 5000 lekë, të cilat janë rishtypur në vite të ndryshme duke përmirësuar elemente sigurie të cilat rritën ndjeshëm besueshmërinë ndaj parasë dhe e bënë atë më të fortë ndaj falsifikimit. Në rishtypjen e kartëmonedhave është ruajtur pamja (vizatimet e tyre), por veç elementeve të sigurisë kanë ndryshuar edhe firmat në kartëmonedha.

Në vitin 2019 Banka e Shqipërisë prezantoi serinë e re të përmirësuar të kartëmonedhave shqiptare me kurs ligjor.

Seria e re e kartëmonedhave Lek përmban 6 prerje: 200, 500, 1000, 2000, 5000 dhe prerjen e re 10000 Lekë. Kjo seri iu prezantua publikut gradualisht gjatë disa viteve, 2019 - 2022.

Principatat shqiptare dhe rëndësia e tyre historike

Tokat shqiptare në sundimin serb të Stefan Dushanit

Pas sundimit të Shqipërisë nga perandori i Serbisë Stefan Dushani, në vitin 1348 në viset e pushtuara u vunë të afërmit e perandorit. Feudalët shqiptar të pakënaqur nga pushtimi serb, sepse ishin ndaluar vetë-administrimet e përhershme lokale, herë pas here bënin kryengritje kundër sundimit serb. Pas vdekjes së perandorit serb, Dushanit, perandoria Serbe filloi të dobësohet. Në mesin e shekullit XIV Shqipëria kishte disa feudalë të mëdhenj. Ata morën zotërimet feudale që përfshinin disa fshatra dhe qytete. Çdo feudal kishte ushtrinë e tij.

Familjet më të mëdha feudale ishin Topiajt, Ballshët, Dukagjinët, Kastriotët, Muzakajt, etj. Këto familje feudale kanë jetuar në rajonet e Krujës, Shkodrës, Lezhës, Beratit, etj.

Familjet më të mëdha feudale shqiptare formuan principatat e tyre. Principatat kishin udhëheqësin e tyre nga familja feudale e atij vendi. Çdo principatë kishte një territor të përfshirë nga fshatra dhe qytete. Çdo principatë kishte dhe ushtrinë e vet në shërbim të mbrojtjes së territorit dhe pasurisë.

Principatat shqiptare ishin: Principata e Durrësit, e Shkodrës, Muzakajve, etj.

Principata e Durrësit - Topiajt



Në vitet 70 të shek. XIII, bëhet fjalë për një pinjoll të saj, përfaqësues i aristokracisë ushtarake me titullin "miles". Në atë kohë Topiajt ditën t'i bënin vend vetes, duke u shkëputur nga Bizanti e duke vendosur lidhje të ngushta me anzhuinët e Napolit si dhe me Papatin e Romës. Këtyj të fundit, Topiajt i premtuan kalimin e tyre nga riti ortodoks në atë katolik. Për rrjedhojë, kisha e Romës u njohu Topiajve si zotërim të familjes tokat midis rrjedhës së Matit dhe asaj të Shkumbinit, të cilat përputheshin pak a shumë me shtrirjen e Principatës së dikurshme të Arbrit. Të drejtat e Topiajve mbi këto vise u konfirmuan më 1338 edhe nga anzhuinët e Napolit, të cilët e konsideronin veten kryezot të Durrësit e të Arbrit si dhe Topiajt vasalë të tyre. Topiajt ishin shpallur vasalë të mbretit të Napolit, Karl Anzhu I, që në vitin 1272. Megjithatë varësia e tyre nga oborri i Napolit mbeti thjesht formale. Si mbreti Karl I, ashtu dhe pasardhësit e tij, Karl II e Robert Anzhu I, ankoheshin vazhdimisht në aktet e tyre për "mosbindjen" madje edhe për "rebelimet" e vazhdueshme të Topiajve dhe të krerëve të tjerë shqiptarë kundër pushtetit sovran të tyre. Megjithatë, të ndërjegjeshmë se s' do të mund ta ruanin autoritetin e tyre mbi Durrësin dhe Arbrin, anzhuinët këmbëngulnin t'i mbanin afër Topiajt, qoftë duke u falur herë pas here "fajet", qoftë duke u dhënë edhe provizione (para) të mëdha vjetore, siç vepruan më 1338 me kontin Tanush Topia. I vëllai i këtij të fundit, Domeniku, ishte klerik i lartë dhe në vitin 1336 mbreti Robert Anzhu e kishte tërhequr në oborrin e Napolit si kapelan e këshilltar të tij.

Marrëdhëniet e Topiajve me anzhuinët e Napolit pësuan një ngrirje të fortë në kohën e sundimit të Andreas, djalit të Tanushit. Ndonëse që martuar me një vajzë jashtë martesë të mbretit Robert, Andre Topia tregohet fare i pabindur ndaj tij, aq sa anzhuinë vuri njerëz dhe e vrau.

Zotërimi i Topiajve arriti fuqinë dhe shkallën më të lartë të organizimit në kohën e princit Karl Topia, djali i madh i Andreas, që erdhi në fuqi në vitin 1359. Brenda viteve 50 të shek. XIV ai arriti të konsolidonte në luftë me rivalët e shumë pushtetin e vet në trevën e Arbrit. Ashtu si paraardhësit e vet, Karl shfrytëzoi mjeshhtërisht për këtë qëllim lidhjet e hershme të familjes së tij me anzhuinët e Napolit. Ai nuk ngurronte të vinte në dukje "lidhjet e gjakut" që kishte me këta të fundit nga e ëma. Në këtë kuptim ai i shtoi stemën familjare të Topiajve, që paraqiste një luan, edhe simbolin e anzhuinëve, zambakun.

Principata e Muzakajve



Principata e Muzakajve ishte një principatë e pavarur e sunduar nga familja fisnike shqiptare Muzaka, me kryeqytet Beratin, por duke përfshirë në kuadër të këtij organizimi edhe pjesë të tjera të Shqipërisë Qendrore dhe Jugore si dhe Maqedoninë



PRINCIPATAT E ARBËRIT

- Principata e Arbërit
- Principata e Topiajve
- Principata e Balshajve
- Principata e Muzakajve
- Principata e Gropajve
- Principata e Loshajve
- Principata e Shpatajve
- Principata e ...

Perëndimore. Njëri nga sundimtarët e parë të saj ishte Andrea Muzaka I, mbretërimi i të cilit u njoh edhe nga Perandori Bizantin. Gjatë Betejës së Savrës, osmanët pushtuan Beratin nga princi Balsha II, së bashku me Krujën dhe Ulqinën, por ata u tërhoqën shpejt nga të gjitha ato qytete duke mbajtur vetëm Kastorinë nën kontrollin e tyre të përhershëm. Disa burime shpjegojnë se osmanët ndoshta kanë mbetur në Berat me qëllim që ta përdorin atë si pikëmbështetje për të pushtuar Vlorën. Në vitin 1417 territoret e Principatës, duke përfshirë Vlorën dhe Beratin, u bënë pjesë e Perandorisë Osmane. Historiana bizantine e shek. XI-XII, Ana Komnena, përmend e para emrin e një fisniku nga familja Muzaka, i cili rreth vitit 1090 ishte ndër komandantët më të besuar të perandor Aleks Komneni I. Origjina e familjes ishte nga zona e Oparit, ku Muzakajt kishin zotërimet fillestare të tyre me fshatrat Voskop, Lavdar, Xerje, Bec, Mazrek, Marjan, Dushan, Zerec etj. Kronisti Gjon Muzaka (1510) kujton se varret e të parëve të familjes ndodheshin pranë kishës së Shën Triadhes në Tudar të Oparit. Autoriteti dhe roli politik i Muzakajve dëshmohej qartë që në shek. XIII.

Gjatë luftërave me anzhuinët e Napolit (1273-1281), i pari i derës së Muzakajve, Gjoni Muzaka I, u shqua si një ndër krerët kryesorë të qëndrësës. I zënë rob gjatë një beteje, në tetor Gjoni u burgos në këshqjellën e Brindizit bashkë me tre bashkëpunëtorët e tij, Dhimitër Zogun dhe Kasnec e Guljelm Blenshtin. Por, nën presionin e krerëve shqiptarë, mbreti Karl Anzhu I u detyrua ta lironte atë vitin tjetër, kundrejt premtimit se "nuk do të fliste e nuk do të vepronte më kundër tij".

Krijuesi i një principate të vërtetë të kësaj familjeje ishte pikërisht despot Andrea Muzaka II (1335-1372). Nën drejtimin e tij, Muzakajt u vunë në krye të lëvizjeve anti bizantine të viteve 1335-1341, që përfshiu trevat shqiptare jugore. Me atë rast, despot Muzaka lidhi edhe një aleancë me anzhuinët e Napolit. Në paktet e nënshkruara në Durrës, më 30 dhjetor 1336, me Luigj Anzhunë, nip i mbretit Robert, Andrea Muzaka II njohu për kryezot mbretin e Napolit, i cili nga ana e tij i konfirmoi fisnikut shqiptar pronat, titujt e gradat e dhuruara nga perandorët e Bizantit. Si peng të besnikërisë ndaj sovranit anzhun, Andrea Muzaka II duhej të linte në Durrës, pranë përfaqësuesit të mbretit të Napolit, njërin prej djemve të tij.

Pas vdekjes së car Dushanit dhe shthurjes së Perandorisë Serbe, despot Andrea Muzaka II i zgjeroi më tej kufijtë e zotërimeve të tij në drejtim të zonës së Korçës e Devollit, duke dëbuar prej andej sundimtarët serbë të vendosur rishitja. Nga fundi i viteve 60 ai aneksoi zotërimet e zotit të Karavastës, sebastokratorit Vlash Marënga, pushtoi këshqjellën e rëndësishme të Bregut, doli mbi Shkumbin e mori tokat e Gosës e të Garunjës, duke u ballafaquar drejtpërdrejt me princin e fuqishëm të Arbrit, Karl Topinë. Po në atë kohë Andrea Muzaka II mori Vlorën e Kaninën nga duart e sebastit Aleksandër, që sundonte aty pas vdekjes së despotit Ivan Komnen.

Megjithatë, despot Muzaka shumë shpejt ia kaloi në formë paje këto dy qytete vëllait të vogël të Balshajve, Balshës II, pas martesës së këtij me vajzën e tij, Komitën. Siç duket, në bazë të aleancës midis këtyre dy familjeve fisnike shqiptare qëndronte rivaliteti i tyre i përbashkët me Topiajt e veçanërisht me sundimtarin serb Vukashin, atë kohë zot i Kosovës e i gjithë Maqedonisë Perëndimore, deri në Kostur. Pikërisht me ndihmën e Balshajve, despot Andrea Muzaka II theu më 1370 pranë Kosturit ushtrinë e kralj Vukashinit. Kjo fitore u përhëndet edhe nga perandori i Bizantit, Johani Paleologu V, i cili me këtë rast i konfirmoi Andrea Muzakës II titullin e despotit, duke i dhuruar fronin bashkë me shenjën përkatëse dalluese, shqiponjën me dy krerë e me yll në mes. Kjo zëvendësoi emblemën e hershme të Muzakajve, e cila paraqiste një burim që shpërthente nga toka duke u ndarë më dysh.

Bashkë me konfirmimin e titullit despot, perandor Johani Paleologu V i kaloi Andrea Muzakës II edhe të drejtat mbi Kosturin. Ndonjë vit më vonë, me ndihmën e Balshajve e të bujarëve të tjerë shqiptarë,

despot Andrea i rëmbeu Mark Krajleviçit, të birit të Vukashinit, qytetin e Kosturit. Në këtë mënyrë, në fund të jetës së tij, despoti plak, Andrea Muzaka II, kishte përfshirë në principatën e tij Myzeqenë, Beratin, Tomoricën, Skraparin, Këlcyrën, Përmetin, Oparin, Devollin, Kolonjën e Kosturin. Megjithatë, në krahun perëndimor të zotërimeve të Muzakajve, ndihet fort hegjemonia e Balshajve të fuqishëm, të cilët nga Vlorë e Kanina ushtronin ndikim të madh në zonat përreth, deri në Berat, siç e dëshmon edhe mbishkrimi i të ashtuquajturit "Epitaf i Glavinicës" i vitit 1372. Aty nga viti 1374, Muzakajt ishin detyruar të tërhiqeshin edhe nga tokat që kishin zënë para pak vjetësh përtej Shkumbinit, si dhe nga këshqjella e nga tregu i Bregut, në derdhje të Shkumbinit. Këto vende i kaluan rivalit të tyre, princit Karl Topia.

Vdekja e despot Andrea Muzakës II menjëherë pas marrjes së Kosturit (ai u varros në kishën e Shën Ndoit në Durrës), ndikoi gjithashtu në dobësimin e zotërimit të Muzakajve. Ky u nda midis tre bijve të tij: Gjoni, Teodori e Stojës. I pari trashëgoi zotërimet stërgjyshore të familjes, i dyti Beratin e zonën e Myzeqesë, kurse i treti viset nga Devoll në Kostur. Shumë shpejt, në vitin 1375, Stojë Muzakës iu desh të përballonte një sulm të Mark Krajleviçit, i cili me një ushtri mercenare osmane u përpoq pa sukses të rimerrte Kosturin. Deri në pushtimin përfundimtar nga osmanët, më 1385, qyteti mbeti në duar të Muzakajve, siç e vërteton edhe një mbishkrim kitorial në kishën e Shën Thanasit, të ngritur më 1382 nga vëllezërit Stojë e Teodor Muzaka. Stoja vdiq në vitin 1384, kurse vëllai i dytë, Teodori, mbeti i vrarë në betejën e Fushë-Dardanisë, më 1389, ku kishte shkuar me forca të shumta bashkë me fisnikë të tjerë shqiptarë. Vëllai i madh Gjini, pasi kishte kaluar mjaft vjet në burgun e Kaninës, ku e kishte mbyllur i kunati, Balsha II, vdiq edhe ai para vitit 1390 në një çast rrethjeje e shthurjeje të principatës. Osmanët tashmë shfaqeshin rregullisht në zotërimet e tyre dhe në zonën e Korçës ata ishin bërë zotë realë të vendit. Zotërimet e Muzakajve u rruhën kryesisht në viset malore. Mjaft pinjollë të tyre, si djali i madh i Gjinit, Andrea, ishin vendosur në Durrës ku ishin vënë në shërbim të Venedikut.

Periudha e shkurtër e rimëkëmbjes së zotërimit të Muzakajve pas disfatës së osmanëve në betejën e Ankarasë (1402) lidhet me emrin e Teodor Muzakës III, djalit të Andresë. Ky për disa vjet arriti ta shtrijë përsëri zotërimin e Muzakajve në fushën e Myzeqesë, duke ringjallur për këtë konfliktin e vjetër me Topiajt, posaçërisht me kontin Niketë Topia, i cili gjatë një përpjekjeje më 1412 ra rob i Muzakës.

Me rifillimin e sulmeve osmane zotërimi i Muzakajve u prek rëndë. Më 1417, njëherësh me Vlorën, ra edhe Berati. Teodor Muzaka u kthye nga ajo kohë në vasal të sulltanit dhe pasardhësit e tij me përkrahjen e osmanëve apo të Venedikut, mbajtën një minimum të principatës së dikurshme derisa, pas rënies së Shkodrës, më 1478, i fundit i Muzakajve të krishterë, Gjon Muzaka, autori i njohur i Gjenealogjisë së shtëpisë Muzaka (1510), e la vendin dhe u vendos në Mbretërinë e Napolit.

Principata e Kastriotit



Principata e Kastriotit (1389-1444). Kastriotët ishin familje fisnike dhe dinastia drejtuese më e rëndësishme e jetës politike dhe ushtarake të Shqipërisë në shek. XV.

Për pemën gjenealogjike, vend-origjinën dhe veprimtarinë e Kastriotëve gjatë shek. XIV dihet fare pak. Prandaj, për këto çështje, mendimet e historianëve kanë qenë të ndryshme.

Sipas dy historianëve më të hershëm shqiptarë, Marin Barletit e Dhimitër Frangut, Kastriotët ishin nga Mati që, sipas mendimit të kohës, shtrihet deri në bregdet. Në këtë përfundim ata janë nxitur nga pozicioni gjeografik kyç i trevës së Matit, si vend-kryqëzimi i rrugëve që lidhnin krahinat e ndryshme të shtetit të Kastriotëve si në kohën e Gjon Kastriotit, ashtu edhe në atë të Skënderbeut. Kurse periudhëve më të hershme të veprimtarisë së familjes Kastrioti, autorët e sipërpërmendur nuk i kanë kushtuar vëmendje, aq sa në veprat e Marin Barletit e të Dhimitër Frangut nuk përmenden as emri i gjyshit të Skënderbeut. Kurse një autor tjetër arbër, bashkëkohës me dy të parët, Gjon Muzaka, ka rrëfyer se gjyshi i Skënderbeut quhej Pal dhe se, sipas tij, kishte qenë pronar i dy fshatrave të Dibrës së Poshtme, Sinjës dhe Gardhit të Poshtëm, rrëfim ky që mund të merret me një farë rezerve. Tregimi i mësipërm i Gjon Muzakës ka shërbyer si argument kryesor për ndonjë historian të ditëve tona që Dibrën ta konsiderojë si vend-origjinën e Kastriotëve. Po ashtu, si Marin Barleti, edhe Gjon Muzaka ka shënuar se Gjon Kastrioti ka pasur në zotërim Matin. Dhimitër Frangu ka shkruar se Kastriotët zotëronin edhe Ujmeshin. Tre autorët e mësipërm i shkruan veprat e tyre në fillim të shek. XVI dhe larg Shqipërisë, kur jetonin si emigrantë në Itali. Më pas, në vitin 1553, një tjetër arbër, Andre Engjëlli, ka shkruar në Romë se paraardhësit e Gjon Kastriotit, përveç Matit, kanë zotëruar Kastorin dhe Ymenestrien. Sipas këtij autori, Gjon Kastrioti ka qenë i biri i Gjergj Kastriotit dhe ky i Kostandin Kastriotit, të mbiqajtur "Mazreku" që kishte vdekur në vitin 1390.

Vepra e Gjon Muzakës është më e saktë dhe më e besueshme se ajo e A. Engjëllit, prandaj thuajse të gjithë studiuesit e sotëm mendojnë se gjyshi i Skënderbeut quhej Pal.

Çështja e origjinës së Kastriotëve ka të bëjë me një periudhë më të hershme nga ajo që nis me gjyshin e që vazhdon me të atin e Skënderbeut. Të shtrira gjatë një harku kohor të tillë mendimet për vend-origjinën e Kastriotëve, që japin autorët e hershëm shqiptarë si M. Barleti, Dh. Frangu, Gj. Muzaka, A. Engjëlli dhe F. Bardhi, si dhe burime të tjera historike, nuk kanë kundërshti ndërmjet tyre, por shfaqen si dëshmi në vijim që flasin për kohë të ndryshme dhe që plotësojnë njëra-tjetrën. F. Bardhi flet për periudhën më të hershme, për trugun gjenealogjik të familjes kur ishte në Has, Gjon Muzaka përmend emrin e gjyshit të Skënderbeut, Pal Kastriotin, duke treguar dy fshatrat që kishte si pronë në Dibër, kurse M. Barleti dhe Dh. Frangu flasin për pasardhësin e Palit, Gjon Kastriotin dhe zotërimet që kishte ky.

Pozita shoqërore e familjes Kastrioti u fuqizua si rrjedhojë e përpjekjeve të pinjollëve të ndryshëm të saj, disa prej të cilëve kjo rrugë i shtriu përtej vend-origjinës së tyre.

Nga nëntë fëmijët që lindi Vojsava dhe që arritën moshën madhore, shtatë kishin lindur para vitit 1405.

Zgjerimi e fuqizimi i shtetit të Gjon Kastriotit përkoi me rënien e dy shteteve kufitare me të, të Balshajve e të Topiajve, dhe sidomos pas dobësimit të fuqisë ushtarake të Perandorisë Osmane, kur ushtria e saj pësoi një disfatë të rëndë prej trupave mongole në betejën e Ankarasë të vitit 1402. Gjatë këtij viti (1402), zotërimet e Gjon Kastriotit u shtrinë në drejtim të viseve bregdetare dhe u bënë kufitare me ato të Venedikut. Që nga viti 1406, Gjon Kastrioti shfaqet si një partner i rëndësishëm në marrëdhëniet me shtetet e huaja, ambasadorët e tij shkonin në Venedik, Raguzë e në vende të tjera dhe ai cilësohej prej tyre si zot "shumë i fuqishëm", "i madhërishtëm" etj. Ndërkohë edhe ambasadorët e tyre dërgoheshin pranë Gjon Kastriotit. Pushteti dhe ndikimi i tij mbi zotët e tjerë ishin të fuqishëm, prandaj më 1408 ai ishte i pranishëm si garant i paqes, që u nënshkrua në rrethinat e Durrësit, midis Venedikut dhe Balshajve.

Shtetin e Gjon Kastriotit e përshkonin rrugë tregtare shumë të rëndësishme. Ndër to, në rrafshin perëndim-lindje me të rrahurat ishin dy. Njëra rrugë lidhte viset bregdetare me Prizrenin, që duhet të ketë qenë qendra administrative e shtetit të Gjon Kastriotit. Në këtë qytet të lashtë kryqëzoheshin rrugë tregtare shumë të rrahura dhe që shkonin në drejtim të Prishtinës, të Pejës, të Tetovës etj. Traseja e rrugës së dytë kalonte nga bregdeti nëpër krahinën e Matit, vijonte në drejtim të Dibrës dhe ndiqte rrjedhjen e sipërme të lumit Vardar për të arritur në Shkup. Në dokumentet mesjetare këto dy rrugë janë shënuar me emra të ndryshëm të qyteteve nga ato kalonin: rruga e Lezhës, rruga e Prizrenit, rruga e Prishtinës dhe rruga e Shkupit. Interesat ekonomikë e tregtarë të Gjon Kastriotit shtriheshin edhe përtej zotërimeve

të tij, në Fushë-Dardani, madje edhe përtej Shkupit, ku mund të bliheshin argjend, plumb e hekur si dhe drithë me çmime më të ulëta se në rajonet e tjera, prodhime bujqësore të viseve të ngrohta, si pambuk, oriz, susam etj. Kështu shpjegohen, p.sh., lidhjet e tij me manastirin e Hilandarit në Malin e Shenjtë, që gjendet në brigjet e detit Egje. Këtyj manastiri, Gjon Kastrioti i dhuroi në vitin 1426 dy fshatra nga pronat e veta në rajonin e Gostivarit, i bleu pirgun e Shën Gjergjit (i njohur edhe me emrin Pirgu Shqiptar) dhe në këtë manastir një nga djemtë e tij, Reposhi, e kaloi jetën si murg derisa vdiq më 25 korrik 1431. Në epigrafin e varrit, Reposhi mban titullin e lartë fisnik dukë.

Gjon Kastrioti siguronte të ardhura të rëndësishme nga doganat, tregtia e drithit, e metaleve, e kripës etj.

Gjon Kastrioti ndoqi një politikë aktive për zgjerimin e fuqizimin e shtetit të tij, me gjithë kushtet e vështira që ishin krijuar prej sulmeve e pushtimeve osmane. Ai forcoi lidhjet me Republikën e Venedikut dhe qysh në vitin 1407 arriti të siguronte prej saj qytetarinë veneciane, e cila, bashkë me fëmijët e tij, iu rinjoh edhe në vitin 1413. Në fillim të vitit 1410 Venediku pranoi kërkesën e Gjon Kastriotit që të kishte banesë në Ulqin dhe, në rast se do të dëbohej nga zotërimet e tij prej osmanëve, ai bashkë me familjen të banonte në atë qytet.

Si çështje parësore e aktivitetit politik të Gjon Kastriotit ishin marrëdhëniet e tij me fqinjët lindorë, pushtuesit osmanë, fuqia ushtarake e të cilëve ishte e papërbalueshme prej tij. Siç del nga fraza e dokumentit të vitit 1411, të cituar pak më sipër, Gjon Kastrioti ishte afruar me komandantin osman të Shkupit, Bajazitin, aq sa mund të komandonte edhe 300 kalorës osmanë, e dhënë kjo që lejoi të supozohet se ai mund të ketë qenë së paku në postin e subashit të Tetovës.

Fuqizimin më të madh ai e arriti në kohën kur në krye të tij doli djali i vogël i Gjonit, Gjergj Kastrioti-Skënderbeu.

Principata e Dukagjinit



Principata e Dukagjinit (1387-1444) u krijua nga vëllezërit Pal dhe Leka Dukagjini I dhe pastaj u regullua nga pasardhësit e Palit, Tanush Dukagjini dhe Pal Dukagjini II, principata bënte pjesë në Lidhjen e Lezhës. Biri i Palit, Lekë Dukagjini është njëri ndër figurat më prominente në historinë e Shqipërisë.

Principata e Dukagjinit (shqip: Principata e Dukagjinit) i referohet domeneve (zotërimet) të familjes shqiptare të Dukagjinit në veri të Shqipërisë dhe në pjesën perëndimore të territorit të sotëm të Kosovës në shekullin XIV dhe XV. Në shtrirjen e tyre maksimale, domenet e Dukagjinit shtriheshin nga Zadrimeja e Epërme në veriperëndim deri në Rrafshin e Dukagjinit në Kosovën perëndimore. Qendra politike e familjes Dukagjini ishte Lezha deri në vitin 1393 kur iu dorëzua Venedikut për të mos rënë nën pushtetin osman. Sanxhaku osman i Dukagjinit u emërua sipas sundimit të familjes në zonat që e formuan atë.

Familja Dukagjini shfaqet për herë të parë në të dhënat historike në vitin 1281, kur paraardhësi i tyre Gjin Tanushi mori titullin duk. Ata mund të kenë qenë pasardhës të familjes së hershme Progoni, e cila pretendonte afërsisht të njëjtin territor si ata. Dukagjinët formuan domenet e tyre të pavarura kur u rebeluan kundër familjes Balshaj. Kjo ngjarje duhet të ketë ndodhur në vitin 1387, sepse atë vit vëllezërit Pal dhe Lekë Dukagjini nënshkruan një marrëveshje tregtare me Republikën e Raguzës dhe lejuan kalimin e lirë të tregtarëve të republikës nëpër territoret e tyre. Më vonë u sundua nga pasardhësit e Palit, Tanush Dukagjini dhe Pal Dukagjini II. Në qershor të vitit 1393, dy vëllezërit Dukagjini ia dhanë Venedikut, të cilin e mbajti deri në vitin 1478, pavarësisht përpjekjeve të mëvonshme të familjes për të rimarrë qytetin. Pjesa e brendshme malore, e vështirë për t'u aksesuar në lindje mbeti nën kontrollin e Dukagjinit. Në vitin 1398, Tanush III (djali i Palit I), iu dorëzua osmanëve, por në vitin 1402, pas disfatës së tyre në Ankarë dhe kapjes së Sulltan Bajazitit I, ai u çlirua prej tyre.

Përfaqësuesit kryesorë të Dukagjinit në shekullin XV ishin Pali II me djemtë e tij, Leka III dhe Nikollë Dukagjini II. Pali Dukagjini dhe i biri Nikolla morën pjesë në kuvendin e Skënderbeut të Lezhës, më 2 mars 1444, si vasalë të Lekë Zaharisë, zotit të Saitit dhe Danjës. Leka III kërkoi falje që nuk mundi të merrte pjesë në takim. Pas vdekjes së Palit II (1446), Leka mori Dukagjinin dhe Nikolla mori pjesë në Luftën Shqiptaro-Veneciane (1447-1448).



Akademia e Forcave të Armatosura, Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë ofron për herë të dytë në vitin akademik 2022-2023, programin e ciklit të dytë të studimeve: “Master Profesional në Siguri Kibernetike në Fushën e Mbrojtjes”.

*Ministri i Mbrojtjes **Niko Peleshi**, teksa fton të gjithë të rinjtë të aplikojnë shprehet se: “Kjo është një mundësi fantastike për vijimin e studimeve universitare në një nga fushat më prestigjioze dhe më të lakmuara të momentit”.*

Aplikimi dhe përzgjedhja për ciklin e dytë të studimeve, Master Profesional, do të zhvillohet nga data 3 - 7 tetor 2022,

ndërsa pas përfundimit të të gjithë procesit të përzgjedhjes, studimet do të nisnin më 1 nëntor 2022.

Ky program studimi ka për qëllim të formojë gjeneratën e re të profesionistëve ushtarakë dhe civilë, të cilët do të përfitojnë njohuritë e duhura dhe eksperiencat për të zhvilluar sisteme më të sigurta kompjuterike.